



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 107 Akti

Nr. 244 Vendimi
Tiranë, më 5.3.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Roland Ilia	Relator
Valbona Sanxhaktari	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, në datën 2.3.2020, ora 9:00 dhe në datën 3.3.2020, ora 11:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Skënder Haluci**, me detyrë gjyqtar/kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoji subjektin e rivlerësimit, z. Skënder Haluci, dhe vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5, të nenit 179/b, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në pikën 5, të nenit 3, si dhe në pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit, *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.3.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2, i përbërë nga komisionerët Roland Ilia, Valbona Sanxhaktari dhe Olsi Komici. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioner Roland Ilia.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 21.3.2018, u caktua me mirëkuptim kryesues komisioner Olsi Komici, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, kishte për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me subjektin.

7. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Inspektorati i KLD-së.

Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

8. Në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016 u administrua shkresa me nr. *** prot., datë 13.3.2018, e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, me anë të së cilës u dërgua një raport i hollësishëm dhe i arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit.

9. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit, me shkresën nr. *** prot., datë 26.12.2018 (deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 8.1.2019, të KDZH-

së), në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar *papërshatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Skënder Haluci.*

10. Inspektorati i KLD-së ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

11. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke filluar një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret e vlerësimit: atë të vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale.

12. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në datën 29.1.2020 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për kriterin e pasurisë për subjektin e rivlerësimit; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

13. Subjekti i rivlerësimit, në datën 3.2.2020 u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë, apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 5.2.2020 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 18.2.2020.

14. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit është njohur me dosjen dhe ka marrë një kopje të saj dhe ka dërguar shpjegimet e tij në rrugë zyrtare, trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit, në datën 21.02.2020 vendosi të ftojë z. Skënder Haluci në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, me *e-mail*, në datën 21.02.2020.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Skënder Haluci, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 2.3.2020, ora 9:00 dhe në datën 3.3.2020, ora 11:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.

Subjekti paraqiti kërkesë gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore për çeljen e hetimit për dy kriteret e tjera dhe përjashtimin e trupit gjykues të çështjes në datën 2.3.2020, ora 9:00. Pasi u administrua kërkesa e subjektit të rivlerësimit, u vendos dërgimi i saj për shqyrtim pranë një tjetër trupi gjykues të gatshëm, i ngritur me vendimin nr. ***, datë 21.2.2020, i cili e shqyrtoi këtë kërkesë të subjektit për përjashtimin e trupit gjykues dhe vendosi mospranimin e saj. Ky vendim iu bë me dije subjektit të rivlerësimit në datën 3.3.2020, ora 11:30, gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore të radhës. Ndërsa, me vendimin nr. 4, datë 2.3.2020, në dhomë këshillimi, trupi gjykues vendosi mospranimin e kërkesës së subjektit për riçeljen e hetimit administrativ

për dy kriteret e tjera, vendim i cili iu bë me dije po gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore në datën 2.3.2020, ora 9:00. Seanca dëgjimore e radhës u zhvillua në datën 3.3.2020, ora 11:30. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Skënder Haluci ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ai ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur ato janë kërkuar prej tij. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

Sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

Sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

Ndërsa, sipas kreut VI, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

Referuar vendimit nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklarata e rivlerësimit kalimtar, Vetting” dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI; (ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (d) administruar

raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (dh) administruar raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Inspektoratin e KLD-së; (e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Nisur nga fakti se konstatimet e gjetura rezultuan mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e këtyre gjetjeve.

V. LIDHUR ME VLERËSIMIN E PASURISË

1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, pasi ka përfunduar procedurat e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së tij dhe personave të lidhur, si dhe ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen me dokumentet e administruara.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të pasurisë nga ky institucion, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka dokumentacion të plotë për burimet financiare për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Në konkluzion, në deklaratën “Vetting”, sipas ILDKPKI-së, është konstatuar se:

- *Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, situacion/preventiv punimesh, në lidhje me vlerën e shpenzuar për kryerjen e punimeve të pjesës takuese, në objektin e deklaruar në ***, Tiranë.*
- *Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor në lidhje me të ardhurat e deklaruara nga bashkëshortja A.S., pranë institucioneve ku ka paraqitur vërtetimet përkatëse, në gazetën “***”, Partinë *** dhe nga avokatia.*
- *Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor në lidhje me bursën e përfituar nga A. H., pranë *** COLLEGE *** 2012 - 2014, *** IN ***.*

2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklaratimeve të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë në ILDKPKI, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Skënder Haluci, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të “Deklaratës së rivlerësimit kalimtar, Vetting” dhe aktit të kontrollit nr. *** prot., datë 13.3.2018, të ILDKPKI-së, me nr. indeksi ***, për subjektin e rivlerësimit;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për vitet 2003 - 2017, në raport me të dhënat e “Deklaratës së rivlerësimit kalimtar, Vetting”;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga bankat, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve - gjendje *cash*;
- ç) hetimeve të kryera lidhur me të dhënat e vetëdeklaruara nga subjekti i rivlerësimit kalimtar, gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

Në deklaratën e pasurisë “Vetting”, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këto pasuri:

1. Apartament papafingo, me sip. 242 m², e papërfunduar, në proces legalizimi, në katin e tretë të një ndërtese trekatëshe, të ndërtuar me vëllezërit në truallin e subjektit me sip. 1.400 m², të ndodhur në ***, Tiranë.

Vlera e punimeve të deritanishme: 2,000,000 lekë.

Konstatimi i ILDKPKI-së

- *Rezulton se subjekti ka ndërtim të paligjshëm në vitin 2002, referuar kërkesës për legalizim të bërë në vitin 2006, bashkë me dy vëllezërit e tij.*
- *Nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor situacion/preventiv në lidhje me vlerën e shpenzuar për kryerjen e punimeve të pjesës takuese në objektin e deklaruar.*
- *Dokumentacioni i dorëzuar përputhet me përgjigjen e ardhur nga ZVRPP Tiranë, ALUIZNI dhe DPPPP.*

Hetimi i kryer nga Komisioni

Bazuar në kontratën e shitblerjes nr. ***, të datës 10.1.2015, të lidhur pranë noterit Y.Ç., rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka blerë një sipërfaqe tokë arë me sip. 1.400 m², në zonën e *** Tiranë, mbi të cilën është ndërtuar dhe një ndërtesë trekatëshe (objekt i deklaruar nga subjekti në deklaratën “Vetting”).

ALUIZNI, me shkresën nr. *** prot., datë 17.8.2017, ka dërguar të dhëna lidhur me pasurinë objekt ndërtimor në proces legalizimi, ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit, së bashku me vëllezërit, I., dhe A.H., kanë aplikuar për legalizim të objektit me sipërfaqe ndërtimore 242 m², objekt i ndërtuar mbi sipërfaqen e tokës 1.400 m², të blerë në vitin 2015.

Në deklaratën fillestare të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI (viti 2003), subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri të paluajtshme (objekt/apartament) në emrin e tij.

Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, për këtë pasuri subjekti ka deklaruar: “1 kat apartament banimi me 800 m² oborr, i paregjistruar në ZVRPP. Vlera e truallit: 1,500,000 lekë, blerë në vitin 2004”.

Sipas procesverbalit të mbajtur në ILDKPKI në datën 27.5.2015, subjekti ka deklaruar se për këtë pasuri:

“ - kam investuar në një objekt 3-katësh së bashku me vëllezërit;
- për këtë pasuri zotëroj katin e tretë të këtij objekti të papërfunduar plotësisht;
- kemi investuar vlerën prej 1,500,000 lekësh dhe blerjen e truallit së bashku me vëllezërit në vlerën 140,000 lekë, në vitin 2004;
- veprimet juridike të blerjes së truallit i kemi bërë personalisht, si dhe kërkesën dhe dokumentet për lejen e legalizimit. ”

Komisioni konstatoi se nuk korrespondoi vlera e investimit të deklaruar nga subjekti për këtë pasuri, pasi dy deklarime të tij rezultuan me vlera financiare të ndryshme. Në deklaratën “Vetting” kjo pasuri është deklaruar nga subjekti në shumën 2,000,000 lekë, kurse në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, të dorëzuar në ILDKPKI, është deklaruar shuma prej 1,500,000 lekësh.

Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer ndërtim pa leje, duke aplikuar më pas për legalizim, veprim i cili në dukje komprometon figurën e tij si gjyqtar, kjo duke pasur parasysh se në momentin e ndërtimit të objektit ndërtimor nuk ishte rregulluar as marrëdhënia juridike e subjektit me truallin.

Subjekti ka deklaruar se këtë pasuri objekt ndërtimor ka filluar ta ndërtojë në vitin 1997, në kohën kur pasuria mbi të cilën është ndërtuar kjo pasuri ka qenë tokë arë. Pasuria tokë arë është blerë nga subjekti në vitin 2015, pra, shumë kohë pasi objekti ndërtimor ishte ndërtuar, si dhe subjekti ka aplikuar për legalizim të objektit ndërtimor të ndërtuar pa leje ndërtimi vetëm në vitin 2006.

Në përgjigje të pyetësorit të dërguar nga Komisioni, subjekti ka deklaruar:

“ - Siç kam deklaruar edhe më parë, pasuria truall prej 1.400 m² është blerë nga ana ime faktikisht nga një i njohuri im që në vitin 1997, me një marrëveshje verbale në shumën 1,400,000 lekë. Në atë kohë, i njohur im i fëmijërisë, i cili quhet I.Z., nuk dispononte dokumentacion të plotë ligjor për këtë sipërfaqe toke dhe kjo ka qenë një marrëveshje mes miqsh dhe pasi të plotësonte dokumentacionin e plotë ligjor do i jepja edhe 140,000 lekë, 1/10 e shumës prej 1,400,000 lekësh, të cilat ia kam dhënë në datën 10.1.2015, kur kemi bërë kontratë shitblerje me nr. ***, datë 10.1.2015. Mbi këtë pronë, fillimisht vëllezërit e mi kanë filluar ndërtimin e banesave të tyre që në vitin 1998 dhe pasi i kanë përfunduar dhe kanë filluar të banojnë aty, kemi filluar ndërtimin edhe për mua në katin e tretë, sipër banesave të vëllezërve, një ‘papafingo’ me sipërfaqe rreth 242 m² e cila edhe sot e kësaj dite nuk është përfunduar. Sipas llogaritjeve të bëra nga ana jonë në këtë papafingo që nga fillimi i ndërtimit deri në fund të vitit 2004, vlera e punimeve ka qenë 1,500,000 lekë, pas vitit 2004 ndër vite janë kryer edhe disa punime shtesë në vlerën 500,000 lekë. Përafërsisht në këtë objekt janë shpenzuar ndër vite 2,000,000 lekë. Vlera e truallit prej 1.400 m² është 1,400,000 lekë, ndërsa vlera e ndërtimit është rreth 2,000,000, për të cilën nuk disponoj situacion të punimeve të ndërtimit, pasi të gjitha punimet janë kryer nga ana jonë dhe jo nga ndonjë firmë ndërtimi.

- Çmimi i blerjes së truallit, vlera e ndërtimit dhe sipërfaqja është siç e kam deklaruar më parë dhe në total investimi për pjesën time ka qenë 3,400,000 lekë. Sipërfaqja totale e ndërtimit është rreth 640 m². Lidhur me ndërtimin e kryer nga ana e vëllezërve për pjesën tjetër nuk kam

dijeni sepse janë shpenzime të kryera prej tyre që nga vitin 1997 dhe kontributi ka qenë 100 % i tyre.”

Në përfundim të hetimit, Komisioni, për këtë pasuri, konstatoi se:

- Sipërfaqja totale e deklaruar nga subjekti ndërtimor nuk duket e saktë, pasi duket se nuk është përfshirë në deklaram dhe një sipërfaqe e cila ndodhet në pjesën e poshtme të sipërfaqeve ndërtimore të deklaruara (sipërfaqja totale e kësaj pasurie rezultoi 842 m² dhe jo 640 m²).
- Vlera e ndërtimit të objektit ndërtimor duket se është nën vlerën e tregut dhe kostos së ndërtimit, referuar të dhënave të viteve përkatëse. Subjekti ka ndërtuar pa leje ndërtimi dhe më pas ka aplikuar për legalizim objekti ndërtimor pa leje.
- Lidhur me ndërtimin e kësaj pasurie subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion provues lidhur me përcaktimin e vitit të ndërtimit, vlerës së ndërtimit, koston e ndërtimit, situacion punimesh, etj.
- Bazuar në çmimin mesatar të ndërtimit, sipas udhëzimeve të Këshillit të Ministrave vlera mesatare e ndërtimit është 24,793 lekë/m². Bazuar në këtë të dhënë zyrtare vlera e objektit ndërtimor me sip. 842 m² llogaritet në total në shumën 20,875,706 lekë.
- Nuk rezultoi se kjo pasuri objekt është krijuar dhe investuar edhe nga vëllezërit e subjektit, për të cilën subjekti nuk paraqiti dokumentacion provues, lidhur dhe me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie. Pasuria objekt ndërtimor është ndërtuar mbi truallin e blerë vetëm nga subjekti me kontratën e shitblerjes në vitin 2015.
- Bazuar në analizën financiare të hartuar nga Komisioni dukej se subjekti ishte në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie për periudhën 1997 – 2005.

Për të gjitha gjetjet e mësipërme, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, për të dhënë argumentet dhe për të paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti, në mënyrë të përmbledhur ka deklaruar:

“ - Në deklaram jam fokusuar te pjesa takuese e imja, prej 242 m², e cila ka përfunduar të ndërtohet në vitin 2004.

- Sa i përket sipërfaqes në pjesën e poshtme të sipërfaqeve ndërtimore, unë nuk kam pjesë takuese, pasi kjo pasuri është ndërtuar dhe posedohet nga vëllezërit e mi dhe detajimi i këtij fakti në deklaramet e mia nuk është çmuar i nevojshëm, për sa kohë unë nuk kam pjesë takuese në pjesën e poshtme të sipërfaqeve ndërtimore.

- Sa i përket vlerës së objektit, sqaroj se ky objekt është ndërtuar nga familjarët e mi dhe shpenzimet e mia kanë qenë për blerjen e materialeve të ndërtimit. Bashkëngjitur po ju dërgoj një akt vlerësimi të objektit të hartuar nga ekspertja e licencuar për pjesën time takuese, ku përcaktohet qartë se vlera e pjesës time takuese është 2,000,000 lekë.

- Sa i përket faktit që objekti është ndërtuar pa leje dhe më pas është aplikuar për legalizim objekti, sqaroj se ka filluar në vitin 1997, kohë në të cilën vëllezërit e mi ishin larguar nga qyteti i Bajram Currit për shkak të trazirave të asaj kohe dhe KPK ka mbajtur më parë qëndrim me vendim të formës së prerë dhe subjekti nuk është penalizuar për këtë fakt.

- Referimi Juaj në kostot e Entit të Banesave për vitet përkatëse në fakt nuk i përgjigjet realitetit, pasi kostot e përlllogaritura nga Enti i Banesave janë llogaritur duke përfshirë pagesat për

kompanitë e ndërtimit, ku përfshihen pagimi i kostos së punëtorëve dhe specialistëve të ndërtimit, fitimit të kompanisë së ndërtimit, ndërkohë që në rastin konkret punimet janë kryer nga ana jonë dhe nuk kemi paguar kosto pune.

- Keni anashkaluar faktin se katet e poshtme të këtij ndërtimi janë ndërtuar dhe poseduar nga vëllezërit e mi që nga viti 1997 dhe në vijim, duke më ngarkuar koston (e fryrë) e këtij ndërtimi 100 % mua si subjekt, kur në fakt unë kam vetëm katin e tretë, të papërfunduar ende sot, me sipërfaqe 242 m².

- Për të hedhur poshtë konkluzionin dhe barrën e provës që më keni ngarkuar lidhur me këtë fakt, bashkangjitur po ju paraqes provat përkatëse.

- Nga ana e Komisionit po mbahet një standard i dyfishtë në arritjen e konkluzionit edhe për sa i përket vlerës dhe kostos së ndërtimit.

- Sipas ortofotove të pasqyruara nga ekspertja është e qartë se ky objekt është evident edhe në ortofotot e vitit 1999.

*- Sa i përket burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë së vëllezërve të mi, më duhet të sqaroj se vëllezërit e mi, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, në cilësinë e personave të tjerë të lidhur me mua si subjekt rivlerësimi, nuk kanë detyrim që të justifikojnë burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë së tyre dhe kjo analizë ligjore është pranuar edhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, në vendimin nr. ***, datë 17.7.2019.”*

Lidhur me këtë pasuri, Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka paraqitur prova për të vërtetuar plotësisht që ky objekt ndërtimor është ndërtuar nga ai së bashku me vëllezërit dhe cili ka qenë kontributi i secilit për sipërfaqen e pretenduar. Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion provues lidhur me burimin e të ardhurave dhe mundësitë financiare të vëllezërve, për ndërtimin e pjesës së pretenduar.

Subjekti ka deklaruar që vëllezërit e tij nuk janë persona të lidhur dhe nuk kanë detyrim që të vërtetojnë burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë së tyre, megjithëse kjo pasuri është pretenduar se është ndërtuar në tokën e blerë nga subjekti. Këto qëndrime të subjektit bien në kundërshtim me vetë provat që ka sjellë subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit, pasi referuar akt inspektimit të paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se subjekti ka qenë paditës i vetëm në procesin gjyqësor me shoqërinë përmbartimore dhe UKT-në Tiranë, lidhur me përfitimin e të drejtave mbi këtë pronë.

Subjekti ka paraqitur si provë një aktekspertim, ku pretendohet se objekti ndërtimor është ndërtuar në vitet 1997 - 2002 dhe se kostoja e ndërtimit të këtij objekti është në vlerën 8,264.5 lekë/m², sipërfaqe ndërtimi. Përcaktimi i kësaj vlere nga eksperti nuk përkon me koston e ndërtimit për m² të Entit Kombëtar të Banesave për këto vite, të cilat vetë eksperti i përmend si referencë në aktekspertim. Vlera e kostos së ndërtimit për sipërfaqe ndërtimi në këto vite, sipas citimit të ekspertit, varion nga 20,709 lekë/m² deri në 28,641 lekë/m², ndërsa vlerën për m² të pasurisë së subjektit e ka llogaritur 8,264 lekë/m².

Subjekti ka pretenduar se objekti është ndërtuar nga vëllezërit, por nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues, si dhe as prova që vërtetojnë certifikimin e vëllezërve si specialistë të fushës së ndërtimit.

Në përfundim, Komisioni, për këtë pasuri, arriti në përfundim se:

- Komisioni krijoi bindjen bazuar në përgjigjet e subjektit, si dhe aplikimin për legalizim lidhur me kontributin e bërë nga subjekti i rivlerësimit dhe dy vëllezërit e tij për këtë pasuri.

- Vlera e investimit të subjektit për këtë pasuri është llogaritur në raport me kontributin e tij, pra, respektivisht 1/3 e vlerës së gjithë pasurisë objekt ndërtimor.
 - Subjekti nuk ka deklaruar dhe provuar vlerën e saktë të ndërtimit të këtij objekti ndërtimor dhe në veçanti të pjesës së tij takuese.
 - Vlera e pasurisë është llogaritur bazuar në çmimin mesatar të kostos të ndërtimit për vitet 1997 - 2005, sipas deklaramit të subjektit lidhur me periudhën e ndërtimit të pasurisë objekt ndërtimor. Sipas kësaj llogaritjeje, vlera e ndërtimit, duke marrë parasysh 1/3 e sipërfaqes totale të ndërtimit dhe çmimit mesatar të kostos së ndërtimit për periudhën 1997 – 2005, është 6,958,568 lekë.
 - Subjekti rezultoi në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie. Kjo shihet qartë në rezultatin financiar të pasqyruar në vijim në vendim, për të gjithë periudhën 1997 – 2005, ku një ndikim në rezultat ka pikërisht edhe investimi i bërë në ndërtimin e kësaj pasurie.
 - Subjekti nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm dhe mundësitë financiare të vëllezërve të tij për ndërtimin e pjesës tjetër të objektit ndërtimor, pra, për 2/3 të të gjithë sipërfaqes së objektit ndërtimor.
 - Lidhur me këtë pasuri rezultoi se subjekti ka bërë deklaramit të pasaktë, si dhe është në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie me burime të ligjshme¹.
- 2. Tokë arë,** me sip. 1.400 m², nr. pasurie ***, z. k. ***, ndodhur në ***, Tiranë, fituar me kontratë shitblerje nr. ***, datë 10.1.2015, të lidhur para noterit Y. Ç., blerë me shkresë dore që nga viti 2004, nga një i njohuri i subjektit.
 Vlera: 140,000 lekë,
 Burimi i krijimit: paga e subjektit ndër vite.
 Pjesa takuese: 100 %.

Konstatimi i ILDKPKI-së

Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe përgjigjen e ZVRPP-së Tiranë.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratë shitblerjeje me nr. ***, për pasurinë tokë arë me sip. 1.400 m², në datën 10.1.2015. Vlera e blerjes së pasurisë sipas kësaj kontrate është përcaktuar 140,000 lekë. Pagesa e vlerës 140,000 lekë është bërë në llogarinë e noterit dhe pas daljes së certifikatës së pronësisë në emrin e subjektit është përcaktuar se kjo shumë do të kalojë më pas në llogarinë e palës shitëse.

Për këtë pasuri subjekti është pajisur me certifikatë në datën 16.1.2015, për vërtetim pronësie të pasurisë tokë arë, me sip. 1.400 m², me nr. pasurie ***, ndodhur në ***, Tiranë.

Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar se këtë pasuri e ka blerë në vitin 2004, por se nuk dispononte dokumentacion ligjor provues për blerjen e saj.

Në deklaratën periodike vjetore të deklaramit të pasurisë të vitit 2004, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar: *Pasuri 1-katëshe apartament banimi, 800 m² sipërfaqe oborri, i paregjistruar në ZVRPP. Vlera e truallit: 1,500,000 lekë, blerë në vitin 2004.*

Në përgjigje të pyetësorit të dërguar nga Komisioni, subjekti ka deklaruar: *“Siç kam deklaruar edhe më parë, pasuria truall prej 1.400 m² është blerë nga ana ime faktikisht nga një i njohuri*

¹ Shihni analizën financiare përmblendhëse në vijim.

*im që në vitin 1997, me një marrëveshje verbale në shumën 1,400,000 lekë. Në atë kohë, i njohur im i fëmijërisë, i cili quhet I.Z., nuk dispononte dokumentacion të plotë ligjor për këtë sipërfaqe toke, dhe kjo ka qenë një marrëveshje mes miqsh dhe pasi të plotësonte dokumentacionin e plotë ligjor do i jepja edhe 140,000 lekë, 1/10 e shumës prej 1,400,000 lekësh, të cilat ia kam dhënë në datën 10.1.2015, kur kemi bërë kontratë shitblerje me nr. ***, datë 10.1.2015.”*

Në përfundim të hetimit të kryer, Komisioni konstatoi se:

- Deklarimet e subjektit në deklaratën “Vetting” lidhur me kohën (vitin) dhe vlerën e blerjes së kësaj pasurie nuk përkojnë me deklaratat periodike vjetore dhe me përgjigjet e pyetësorit. Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar vlerën e blerjes në shumën 140,000 lekë dhe në përgjigje të pyetësorit ka deklaruar vlerën e blerjes në shumën 1,400,000 lekë. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004 subjekti ka deklaruar se vlera e truallit të blerë është 1,500,000 lekë.
- Subjekti i rivlerësimi duket se ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën “Vetting” lidhur me vlerën e blerjes së kësaj pasurie. Duke mos përcaktuar në kontratë vlerën e saktë të blerjes së kësaj pasurie janë shmangur edhe detyrimet përkatëse në buxhetin e shtetit (subjekti ka kryer evazion fiskal me deklarimin e vlerës së shitblerjes prej 140,000 lekësh të kësaj pasurie dhe jo të vlerës reale të saj).
- Subjekti i rivlerësimi nuk ka paraqitur dokumentacion provues për blerjen e pasurisë truall në vitin 1997, mbi të cilën është ndërtuar dhe objekti trekatësh + papafingo. Kjo pasuri truall rezultoi e blerë vetëm në vitin 2015 me kontratë shitblerje pranë noterit dhe në vlerën 140,000 lekë.
- Nuk është dokumentuar dhe nuk është paraqitur asnjë marrëveshje me shkrim për të provuar se kjo pasuri është blerë që në vitin 1997 dhe as në vitin 2004 nga subjekti.
- Vlera e blerjes së kësaj sipërfaqeje tokë truall në dukje duket shumë më e ulët se vlerat e tregut për zonën në fjalë. Bazuar në çmimin e hartës së vlerës së tokës, të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, rezultoi se vlera e tokës për m² në Sauk është 27,104 lekë/m².

Vlera me të cilën është vlerësuar kjo pasuri me sip. 1.400 m², në analizën financiare të hartuar nga Komisioni është 37,945,600 lekë, sipas hartës së vlerës së tokës në vitin e blerjes.

Bazuar në analizën financiare duket se subjekti është në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie në datën 10.1.2015. Deri në këtë datë nuk dokumentohen tërheqje bankare që të mbulojnë vlerën e blerjes. Gjithashtu, nuk është bërë asnjë deklaram në deklaratën periodike vjetore lidhur me ndryshimin e gjendjes së kursimeve *cash* në vitin 2015.

Për të gjitha gjetjet e mësipërme, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës subjektit, për të dhënë argumentet dhe për të paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

Në përgjigje të rezultateve, subjekti, në mënyrë të përmbledhur, ka deklaruar:

“ - Konstatimi Juaj lidhur me vlerën e blerjes është i saktë, por kjo ka ndodhur për shkak të pakujdesisë time, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004.

- Trualli si pasuri nuk është blerë nga unë në vitin 2004 por në vitin 1997.

- Çmimi i pasurisë së paluajtshme në fjalë, të blerë prej meje në vlerën 1,400,000 lekë, u shndërrua në një vlerë më të ulët në kontratën e shitjes prej 140,000 lekësh, për arsye se

ndryshimi i çmimit nga kontrata e shitjes së pasurisë në vitin 2015 dhe asaj të deklaruar në deklaratën 'Vetting', si dhe në shpjegimet e mija, ka ardhur për shkak të mospasqyrimin të marrëdhënies së kaparit të vitit 1997, në kontratën e shitblerjes të vitit 2015. Jam treguar jo shumë i vëmendshëm dhe i qartë në lidhje me shpjegimin e duhur të situatës dhe raporteve të mija me këtë pronë. Nuk është deklaruar kjo pasuri para vitit 2015 në pronësinë time, pasi sipas Kodit Civil, në rastin e shitjes (me rezervë), pronësia kalon me pagesën e këstit të fundit nga blerësi, i cili është paguar në vitin 2015 dhe pikërisht në këtë vit është deklaruar nga ana ime.

- Nuk kam qenë dhe nuk kam pasur mundësi faktike apo ligjore në kushtet apo dashjes për të kryer evazion fiskal.

- Aktualisht unë jam në pamundësi paraqitjeje të dokumentacionit provues të kohës, pasi ka humbur. Për të vërtetuar në mënyrë shteruese këtë pretendim timin kërkoj që të thërritet si dëshmitar shitësi dhe personat që ia kanë shitur atij.

- Trualli është blerë në vitin 1997 dhe vlera me të cilën është vlerësuar kjo pasuri prej 1,400 m², në analizën financiare është 37,945,600 lekë, sipas hartës së vlerës së tokës në vitin e blerjes, nuk rezulton e mbështetur në ligj dhe në prova.

- Sjell në vëmendje se në vitin 1997, në zërin kadastral ka qenë 'tokë arë', dhe jo truall.

- Kjo pasuri nuk është krijuar në vitin 2015, dhe as të konsiderohet si transaksion i këtij vitit për të cilin unë të jem i detyruar për të provuar burimin e krijimit të saj.

- Kam pasur më shumë se një mënyrë me anë të së cilës mund të bëhesha pronar i kësaj pasurie të paluajtshme, por kam dashur që me anë të veprimeve të mia të pasqyroja realitetin dhe situatën faktike, atë të vërtetë që ka ngjarë, duke formalizuar në 2015 një veprim juridik të ndodhur në vitin 1997."

Në përfundim, Komisioni, për këtë pasuri, arriti në përfundim se:

- Subjekti ka bërë deklaram të rremë në deklaratën "Vetting" lidhur me vlerën e blerjes së pasurisë tokë me sip. 1.400 m², deklaruar në vlerën 140,000 lekë.
- Subjekti ka bërë deklarime të pasakta ndër vite dhe në deklaratën "Vetting", lidhur me vitin e blerjes dhe vlerën e blerjes së pasurisë tokë arë.
- Subjekti ka deklaruar që toka është blerë në vitin 1997 nga shtetasi I.Z., në vlerën 1,400,000 lekë si pronar i tokës, por rezultoi se ky shtetas nuk dispononte dokument pronësie në atë periudhë për këtë pasuri.
- Nga provat e paraqitura nga subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, rezulton se shtetasi I.Z., ka blerë në datën 7.3.2001 një sipërfaqe tokë prej 17.750 m². Më pas, pjesë të ndryshme të kësaj pasurie i ka shitur nga viti 2001 personave të ndryshëm, deri në 2015, kur i ka shitur dhe subjektit të rivlerësimit sipërfaqen 1.400 m². Komisioni konstatoi dhe se kontratat e shitjeve të pasurive nga shtetasi I.Z., duket se janë me çmime fiktive, pasi bazuar në çmimet e shitjes në raport me sipërfaqet përkatëse, shihet qartë që ato nuk korrespondojnë.
- Bazuar në deklaratën noteriale të datës 11.2.2020, me deklarues shtetasin I.Z., ky i fundit deklaroi se toka është shitur subjektit në vlerën 140,000 lekë në vitin 1997, deklarim i cili kundërshton deklarimin e subjektit se kjo pasuri është blerë në vlerën 1,400,000 lekë dhe se është dhënë kapar në vitin 1997. Në këtë periudhë subjekti ka paguar edhe shumën prej

126,000 lekësh për punimet e kryera nga deklaruesi. Pra, ky deklaram i palës shitëse të pronës (tokë) me sip. 1.400 m², nuk korrespondon me deklaramet dhe pretendimet e subjektit lidhur me këtë pasuri.

- Mosdeklarami i vlerës së saktë nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e kësaj pasurie, ka sjellë shmangie të detyrimeve financiare në buxhetin e shtetit.
- Bazuar në analizën financiare, subjekti është në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie në datën 10.1.2015².
- Gjatë hetimit të kryer nga Komisioni ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit ka pasur një pasuri tokë arë me sip. 890 m², blerë në vitin 1999.

Këtë pasuri subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar në deklaramtën para fillimit të detyrës për vitin 2003. Gjithashtu, nuk është deklaruar në deklaramtën periodike vjetore të vitit 2004 shitja e kësaj pasurie tokë arë (shitur në datën 26.1.2004), si dhe të ardhurat e krijuara nga kjo shitje. Edhe në deklaramtën “Vetting” subjekti nuk ka deklaruar të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie.

Bazuar në analizën financiare Komisioni konstatoi se subjekti dhe bashkëshortja kanë qenë në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie në vitin 1999, në vlerën -1,880,219 lekë.

Për të gjitha gjetjet e mësipërme Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, për të dhënë argumentet dhe për të paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

Në përgjigje të rezultateve, subjekti, në mënyrë të përmbledhur, ka deklaruar:

“ - Unë si subjekt nuk kam investuar në blerjen e kësaj pasurie dhe as kam përfitur nga shitja e saj dhe ky është shkaku pse nuk janë deklaruar as në deklaramtën periodike të vitit 2004 dhe as në deklaramtën ‘Vetting’ nga ana ime.

- Kjo pasuri është blerë nga bashkëshortja ime A.S., në datën 17.6.1999, pra, para lidhjes së martesës ligjore mes nesh dhe për efekt të ligjit kjo pasuri nuk është pjesë e bashkësisë ligjore.

- Kjo pasuri është shitur nga bashkëshortja ime në datën 26.1.2004, para se unë të bëja deklaramin fillestar, i cili është bërë dhe depozituar prej meje në datën 13.2.2004.

- Në deklaramin periodik të vitit 2004, bashkëshortja ime nuk e kishte këtë pasuri si pasuri të paluajtshme dhe as nuk kishte vlerën monetare të përfitur prej shitjes së saj në datën 31.12.2004.

*- Në analizën financiare të hartuar nga ana Juaj për vitin 1999 nuk janë përfshirë të ardhurat nga ‘***’ në vlerën 1,800,000 lekë, pa llogaritur të ardhurat e vitit 1998. Nga praktika e Komisionit ka rezultuar se ‘...mospagimi i taksave për një pjesë të të ardhurave ka qenë detyrim i punëdhënësit dhe se ato nuk mund të paguheshin nga vetë subjekti...’.*

*- Në analizën tuaj financiare për vitin 1999 janë shtuar gjithashtu në mënyrë të padrejtë shpenzimet ‘kosto ndërtimi shtëpi ***’, shpenzime këto që nuk janë kryer nga ana ime në këtë vit në këtë masë, pasi totali i shpenzimeve të kryera nga ana ime për ndërtimin e banesës nga viti 1998 deri në 2004 ka qenë 1,500,000 lekë.*

*- Më duhet të theksoj se nga ana e Kuvendit të Shqipërisë, nr. ***, datë 17.6.2017, me të cilin bashkëshortja ime është kualifikuar si anëtare zëvendësuese për Komisionere Publike, ashtu si*

² Shihni analizën financiare përmbledhëse në vijim.

për shumë anëtarë të tjerë të organeve të rivlerësimit, këto të ardhura janë konsideruar të ligjshme.”

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe përgjigjes së subjektit të rivlerësimit, Komisioni përfundoi analizën financiare për këtë pasuri.

Analiza financiare e pasurisë tokë arë, me sip. 890 m², blerë në datën 17.6.1999, në vlerën 1,000,000 lekë, 100 % në pronësi të bashkëshortes së subjektit, znj. A.S.

Të ardhura nga punësimi 5 muaj, viti 1999, Skënder Haluci	181,703
Të ardhura nga punësimi 5 muaj, viti 1999, A.S.	76,193
Total të ardhura	257,896
Shpenzime jetese 5 muaj, viti 1999	75,000
Kosto ndërtim objekti tek rruga “****”	354,372
Paguar për blerje të tokës me sip. 890 m ² , më 17.6.1999	1,000,000
Total shpenzime	1,429,372
Pamundësia financiare për blerje pasurie	-1,171,476

Komisioni mori në konsideratë shpjegimet e subjektit dhe vlerën e investimit për pasurinë objekt ndërtimor në rrugën “****” dhe e rillogariti në raport me kontributin e tij, pra, respektivisht 1/3 e vlerës së gjithë pasurisë objekt, në vlerën 354,372 lekë.

Në përfundim, Komisioni, për këtë pasuri, arriti në përfundim se:

- Subjekti nuk ka arritur të paraqesë prova bindëse për të kundërshtuar gjetjet e Komisionit lidhur me këtë pasuri dhe rezultoi në mungesë të mundësive financiare për blerjen e saj në shumën prej 1,171,476 lekësh.
 - Këtë pasuri subjekti nuk e ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore për vitet 2003 dhe 2004, të dorëzuara në ILDKPKI.
- 3. Automjet** tip “Mercedes Benz”, viti i prodhimit 2000, me targa AA ***, fituar me kontratë shitjeje nr. ***, datë 22.7.2013, të lidhur para noterit A.XH. Vlera: 400,000 lekë. Burimi i krijimit: paga ndër vite dhe zotërimi 100 %.

Konstatimi i ILDKPKI-së

Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR-ja.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), me shkresën nr. ***, datë 5.6.2018, ka dërguar të dhëna lidhur me këtë automjet të deklaruar në pronësi nga subjekti i rivlerësimit. Sipas dokumentacionit rezultoi se automjeti është blerë nga subjekti në datën 22.7.2013, sipas kontratës nr. ***, në vlerën 400,000 lekë.

Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2013, subjekti ka deklaruar vlerën e blerjes së automjetit në shumën 500,000 lekë.

Lidhur me këtë pasuri, subjekti ka dhënë shpjegime në përgjigje të pyetësorit³ të dërguar nga Komisioni.

Komisioni, bazuar në analizën financiare, konstatoi se subjekti është në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2013, në vlerën prej -1,656,809 lekësh.

Për të gjitha gjetjet e mësipërme, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti, në përgjigje të rezultateve, në mënyrë të përmbledhur ka deklaruar:

“- Analiza financiare e hartuar nga ana juaj është e padrejtë, pasi pavarësisht dorëzimit të dokumentacionit se vajza ime ka përfituar bursë në shumën 16 4000 USD për vitin në fjalë, këto shpenzime janë konsideruar si shpenzime të kryera nga ana ime në masën 1,288,380 lekë.

- Jam në pritje të dërgimit të dokumentacionit me vulë apostile, i cili pasi të përkthehet e të noterizohet do t’ju vihet në dispozicion nga ana jonë.

- Nuk janë marrë parasysh të ardhurat nga puna në Dhomën Kombëtare të Zgjidhjes së Konfliktëve pranë Federatës Shqiptare të Futbollit, bazuar në vërtetimet e dërguara nga ana jonë.

Kjo analizë financiare për këtë vit duhet ribërë nga ana juaj bazuar në shpjegimet e mësipërme, pasi rezulton se është hartuar duke më ngarkuar shpenzime të cilat nuk i kam kryer dhe pa marrë parasysh të ardhurat e mia në këtë periudhë”.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe përgjigjes së subjektit të rivlerësimit, Komisioni përfundoi analizën financiare për këtë pasuri.

Analiza financiare e pasurisë automjet tip “Mercedes Benz”, me targa AA *, datë 22.7.2013, 100 %, në pronësi të subjektit, z. Skënder Haluci**

Të ardhura nga punësimi, 7 muaj 2013, Skënder Haluci	474,788
Të ardhura nga punësimi, 7 muaj 2013, A.S.	0
Të ardhura nga dëmshpërblimi, tërhequr deri në datën 22.7.2013	300,000
Total të ardhura	774,788
Shpenzime jetese 7 muaj	164,528
Shlyer kredi tek “Intesa Sanpaolo Bank”	347,437
Shpenzime transporti Tiranë-Vlorë, 7 muaj, Skënder Haluci	63,000
Shpenzime udhëtimi 7 muaj	168,252
Shpenzime arsimimi A.H., 7 muaj 2013	196,294
Kosto blerjeje, automjet tip “Mercedes Benz”	400,000
Total shpenzime	1,339,511
Pamundësia financiare	-564,723

Komisioni, lidhur me këtë pasuri, arriti në përfundimin se:

- Bazuar në përgjigjet e subjektit dhe provat e paraqitura, Komisioni mori në konsideratë shpjegimet e subjektit lidhur me bursën e përfituar nga vajza në vlerën 14,000 euro në vit, për vitet 2012 – 2014 dhe këtë vlerë e zbriti nga shpenzimet, si vlera të kryera nga subjekti

³Shihni përgjigjen e pyetësorit të dërguar në datën 14.2.2019.

i rivlerësimit. Rezultoi se subjekti ka sjellë dokumentacion provues lidhur me bursën e studimeve të vajzës, të cilat janë marrë parasysht nga Komisioni dhe janë reflektuar në analizën financiare, por nuk ka provuar shpenzimet dhe kostot e plota të jetesës gjatë periudhës së studimit.

- Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion provues lidhur me të ardhurat e bashkëshortes në Federatën Shqiptare të Futbollit për këtë periudhë.
- Llogaritja e gjendjes së kursimeve *cash*, në analizën financiare, është bërë nga Komisioni sipas deklarimeve periodike vjetore të bëra nga subjekti dhe të paraqitura në ILDKPKI.
- Subjekti rezultoi në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2013, në shumën prej -564,723 lekësh.

4. Automjet tip “Jaguar X TYPE”, viti i prodhimit 2004, me targa AA ***, blerë jashtë, me vlerë totale së bashku me doganën 450,000 lekë.

Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga ndër vite dhe zotërimi 100 %.

Konstatimi i ILDKPKI-së

Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR-ja.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), me shkresën nr. ***, datë 5.6.2018, ka dërguar të dhëna lidhur me këtë automjet të deklaruar në pronësi të subjektit të rivlerësimit. Sipas dokumentacionit rezultoi se automjeti është regjistruar nga subjekti në datën 20.10.2015.

Në përgjigje të pyetësorit të dërguar nga Komisioni për këtë pasuri, subjekti ka deklaruar se këtë automjet e ka sjellë nga Mbretëria e Bashkuar dhe vlera e blerjes ka qenë në total 450,000 lekë.

Në përfundim të hetimit të kryer, Komisioni konstatoi se:

- Nuk është përcaktuar dhe dokumentuar vlera e blerjes së këtij automjeti, pasi rezultoi se ka ardhur nga jashtë dhe në dosjen e dërguar nga DPSHTRR-ja dhe nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti mungon kontrata e shitblerjes dhe konfirmimi për pagimin e detyrimeve përkatëse më pas për këtë automjet.
- Bazuar në analizën financiare të hartuar nga Komisioni, rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja nuk kanë pasur mundësi të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2015, në shumën prej -6,387,360 lekësh.
- Nuk u vërtetua që me tërheqjet e bëra nga llogaritë bankare të subjektit të mbulohen: blerja e kësaj pasurie, përballimi i shpenzimeve të jetesës, udhëtimit, si dhe kostot e arsimimit të vajzës në SHBA.

Për të gjitha gjetjet e mësipërme, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

Në përgjigje të rezultateve, subjekti, në mënyrë të përmbledhur ka deklaruar:

“- Në dosjen e formular nga ju ndodhen tri kopje të dokumentacionit për blerjen e këtij automjeti dhe pagimin e detyrimeve doganore në lidhje me të, në të cilin pasqyrohet vlera 2000

GBP, në rubrikën 'total price' (çmimi), deklarata doganore e automjetit ku është pasqyruar çmimi i tij, si më lart dhe detyrimi doganor për t'u paguar në vlerën 76,653 lekë, faturë derdhje në favor të zyrës doganore, e kryer në 'Raiffeisen Bank', datë 14.10.2015, në shumën totale 76,653 lekë.

-Konstatohet se edhe në këtë analizë financiare është përfshirë si shpenzim bursa e fituar nga vajza ime A.H., shpenzim i cili nuk është kryer nga ana ime dhe referuar tabelës së hartuar nga ana juaj mjafton të hiqet ky shpenzim dhe diferenca negative e llogaritur nga ana juaj të zerohet”.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe përgjigjes së subjektit të rivlerësimit, Komisioni përfundoi analizën financiare për këtë pasuri.

Analiza financiare e pasurisë automjet tip “Jaguar X TYPE”, me targa AA *, datë 20.10.2015, 100 %, në pronësi të subjektit, z. Skënder Haluci**

Të ardhura nga punësimi deri më 20.10.2015, Skënder Haluci	801,656
Të ardhura nga punësimi deri më 20.10.2015, A.S.	618,018
Të ardhura nga dëmshpërblimi, tërhequr deri më 20.10.2015	629,400
Total të ardhura	2,049,074
Shpenzime jetese 9 muaj	336,414
Shlyer kredi tek “Intesa Sanpaolo Bank” deri më 20.10.2015	475,812
Shpenzime transporti Tiranë-Vlorë, 9 muaj, Skënder Haluci	81,000
Shpenzime udhëtimi deri më 20.10.2015	465,257
Shpenzime arsimimi A.H., 9 muaj 2015	516,188
Kosto blerjeje automjeti tip “Jaguar X TYPE” – datë 20.10.2015	450,000
Total shpenzime	2,324,670
Pamundësia financiare	-275,596

Komisioni, lidhur me këtë pasuri, arriti në përfundimin se:

- Subjekti nuk arriti të provojë vlerën e saktë të blerjes së këtij automjeti, si dhe ka bërë deklaram të pasaktë për këtë pasuri.
- Subjekti ka paraqitur një kopje të dokumentit “faturë shitje” të automjetit në Mbretërinë e Bashkuar, sipas të cilit, vlera është 2,000 GBP. Subjekti ka pretenduar se kjo faturë është paraqitur edhe më parë prej tij në përgjigje të pyetësorit, e cila është në dosjen e dërguar nga ILDKPKI-ja, si dhe ishte dërguar nga DPSHTRR-ja në Komision. Pas verifikimit nga Komisioni, deklarimi i subjektit nuk rezultoi i vërtetë. Komisioni konstatoi se fatura e shitjes nuk është paraqitur dhe administruar më parë si provë nga Komisioni. Ky dokument i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit nuk konsiderohet si dokument provues sipas legjislacionit shqiptar, pasi është një shkresë e thjeshtë, e përkthyer nga një përkthyes zyrtar dhe noteri konfirmon vetëm nënshkrimin e përkthyesit.
- Bazuar në këtë faturë, rezultoi që shitësi i ka shitur subjektit të rivlerësimit në Mbretërinë e Bashkuar në datën 12.8.2015 këtë automjet. Sipas të dhënave të sistemit TIMS dhe deklarimit të subjektit në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni, rezultoi se në këtë datë (12.8.2015), subjekti i rivlerësimit ishte me pushime në Antalia, Turqi dhe jo në Mbretërinë e Bashkuar, ku pretendon se ka qenë si palë për blerjen e këtij automjeti.

- Subjekti paraqiti dokumentacion provues lidhur me bursën e studimeve të vajzës.
 - Bazuar në përgjigjet e subjektit dhe provat e paraqitura, Komisioni mori në konsideratë shpjegimet lidhur me bursën e përfituar nga vajza në vlerën 181,478 USD, për periudhën 2014 – 2016 dhe këtë vlerë e zbriti nga shpenzimet si vlera të kryera nga subjekti i rivlerësimit. Rezultoi se subjekti ka sjellë dokumentacion provues lidhur me bursën e studimeve të vajzës, të cilat janë marrë parasysht nga Komisioni dhe janë reflektuar në analizën financiare.
 - Subjekti rezultoi në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie në shumën prej - 275,596 lekësh.
- 5. Gjendja në llogarinë rrjedhëse nga paga dhe dëmshpërblimi në “Tirana Bank”.** Balanca për këtë llogari është në vlerën 323,597.83 lekë, të fituara në zbatim të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007, “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist” dhe në vlerën 153,487.35 lekë, të fituara nga paga si kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Konstatimi i ILDKPKI-së

Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Tirana Bank”.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 26.1.2017, të “Tirana Bank” në dosjen e ILDKPKI-së, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka llogari bankare me bilancet: 323,597.83 lekë dhe 153,487.35 lekë. Gjithashtu, referuar dhe përgjigjes nr. *** prot., datë 30.5.2018, të “Tirana Bank” kanë rezultuar të njëjtat vlera me ato të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit.

Të dhënat dhe veprimet bankare për këto llogari janë përfshirë në analizën financiare të hartuar nga Komisioni.

Gjithashtu, nga hetimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore për vitet 2004 - 2016, gjendjen e llogarive bankare të bashkëshortes dhe ndryshimet (shtesat dhe pakësimet) në fund të secilit vit përkatës.

Për gjetjen e mësipërme, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

Në përgjigje të rezultateve, subjekti, në mënyrë të përmbledhur ka deklaruar: *“Bazuar në nenin 22, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, unë nuk kam pasur asnjëherë detyrimin të deklaroj në deklaratat periodike vjetore për vitet 2004 – 2016, gjendjen e llogaritë bankare të bashkëshortes, të cilat janë të ardhura personale të sajat. Këtë detyrim e ka pasur bashkëshortja dhe kam menduar se ky formular është plotësuar në mënyrë të rregullt nga ana e saj”.*

Trupi gjykues konstaton se:

- Bazuar në provat e administruara dhe analizën financiare, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë këtë llogari bankare dhe vlerat e saj në deklaratën “Vetting”.
- Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore për vitet 2004 - 2016, gjendjen e llogarive bankare të bashkëshortes dhe ndryshimet (shtesat dhe pakësimet) në fund të secilit vit përkatës, detyrim ky që rrjedh nga ligji nr. 9049, datë 10.4.2003.

6. Gjendje cash jashtë sistemit bankar (gjendje 1,500,000 lekë).

Burimi i krijimit: kursime nga paga ndër vite, si dhe nga dëmshpërblimi.

Konstatimi i ILDKPKI-së

Të ardhurat e realizuara mundësojnë krijimin e gjendjes cash të deklaruar.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën “Vetting”, ka deklaruar gjendjen *cash* në vlerën 1,500,000. Gjendje *cash*, me një shumë të tillë, kanë deklaruar dhe bashkëshortja dhe vajza e subjektit (deklarata e datës 27.1.2017).

Sipas deklaratës periodike vjetore për vitin 2016, nuk është deklaruar shuma e gjendjes *cash* në vlerën prej 1,500,000 lekësh (kjo deklaratë është plotësuar nga subjekti në datën 27.3.2017).

Subjekti është pyetur lidhur me këto deklarime dhe në përgjigje të pyetësorit ka deklaruar se zotëronte së bashku me personat e lidhur, nga 1,500,000 lekë/secili, në momentin e deklarimit të deklaratës “Vetting”. Në janar të vitit 2017, gjendja *cash* e subjektit, e bashkëshortes A.S., dhe e vajzës A.H., ka qenë respektivisht nga 1,500,000 lekë vazhdimisht.

Deklarimi dhe mosdeklarimi ndër vite i gjendjes *cash*, pasaktësitë në deklaram, ndryshimet dhe mundësitë financiare për krijimin e këtij likuiditeti, janë pasqyruar në analizën financiare të hartuar nga Komisioni dhe i janë dërguar subjektit të rivlerësimit në rezultatet e hetimit.

Trupi gjykues konstaton se:

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë gjendjen *cash* dhe ndryshimet e saj në deklaratat periodike ndër vite (shtesa dhe pakësime).

7. Apartament me sip. 106 m², me nr. pasurie *, z.k. ***, shk. ***, p. ***, Rr. “***”, Tiranë.** Apartamenti është blerë në vlerën 1,600,000 lekë, në bazë të kontratës së shitjes nr. ***, datë 22.5.2003.

Burimi i krijimit: të ardhurat personale nga paga.

Konstatimi i ILDKPKI-së

Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Rezultoi se bashkëshortja e subjektit ka lidhur kontratë shitblerjeje pasurie me shtetasin F.V., në datën 22.5.2003, për blerje apartamenti në vlerën 1,600,000 lekë. Për pasurinë apartament me sip. 106 m², nr. ***, në Rr. “***”, Tiranë, është pajisur me certifikatë pronësie në datën 19.6.2003.

Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti dhe në deklaratën periodike vjetore për vitin 2004, të dorëzuar në ILDKPKI.

Ky apartament rezultoi se i është blerë në vitin 2000, nga nëna e palës shitëse, shtetasit F.V., në vlerën 4,500,000 lekë dhe i është shitur më pas bashkëshortes së subjektit në vitin 2003 në vlerën 1,600,000 lekë.

Bazuar në analizën financiare të hartuar nga Komisioni, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka qenë në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie dhe në mungesë të burimeve të ligjshme në vlerën prej - 5,343,118 lekësh.

Konkluzion i Komisionit në përfundim të hetimit

- Rezultoi se kjo pasuri është blerë me çmim favorizues nga vlera e blerjes së parë në vitin 2000 prej 4,500,000 lekësh, në vlerën e blerjes nga bashkëshortja e subjektit në vitin 2003 prej 1,600,000 lekësh.
- Bazuar në analizën financiare, subjekti dhe bashkëshortja kanë qenë në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie.

Për të gjitha gjetjet e mësipërme, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti, në përgjigje të rezultateve, në mënyrë të përmbledhur ka deklaruar:

*“- Është e vërtetë që në pamje të parë kjo pasuri duket se është blerë me çmim favorizues, por kjo ka ndodhur pasi pasuria është blerë nga shtetasi F.V., shtetas ky që është blerësi i dyqanit tim, të ndodhur në Rr. “***”. Për këtë kemi rënë dakord që do t’ia shisja këtë lokal nëse ai më shlyente kredinë e mbetur në UBA, më jepte 1.900.000 lekë dhe shtëpinë e ndodhur në Rr. “***”, për të cilën ramë dakord se do t’i jepja 1.600.000 lekë.*

- *Kjo marrëveshje jona evidentohet lehtësisht nga datat në të cilat janë kryer veprimet juridike.*
- *Konstatohet se në këtë analizë financiare keni përfshirë si shpenzim të kryer nga unë ‘shlyer kredi tek UBA 4,705.190 lekë’, kur në fakt nga ekstrakti i llogarisë së kësaj kredie, i lëshuar nga UBA në datën 7.2.2020, rezulton se kam shpenzuar për shlyerjen e kësaj kredie vlerën 8,425 USD, ndërsa shuma prej 34,965 USD është shlyer nga shtetasi F.V. Pra, shuma prej 34,965 USD duhet llogaritur si e ardhur dhe jo shpenzim pasi është shlyer nga shtetasi F. V.*
- *Në atë periudhë unë nuk isha subjekt i deklarimit të pasurive, pra, në thelb këto veprime juridike janë marrëdhënie shkëmbimi të këtyre pasurive dhe po të realizoheshin si të tilla nuk do të paguhej asnjë detyrim ndaj shtetit.*
- *Është përfshirë në mënyrë të padrejtë dhe të pambështetur në asnjë provë si shpenzim, ‘Kosto ndërtimi shtëpi *** 869,821 lekë’, shpenzim ky që nuk është kryer nga unë në këtë vit.*
- *Të ardhurat nga paga e bashkëshortes janë llogaritur bazuar vetëm sipas të dhënave të sigurimeve shoqërore dhe jo sipas vërtetimit të lëshuar nga punëdhënësi.*
- *Sipas praktikës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, zbatimi i ligjit të rivlerësimit në kohë, duhet të kryhet në analogji me parimet e përcaktuara në këtë përkufizim dhe që mund të lidhet me të gjithë komponentët e sistemit të rivlerësimit. Sqaroj se dy nga anëtarët e trupit gjykues kanë qenë pjesë e vendimmarrjes në rastin konkret”.*

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe përgjigjes së subjektit të rivlerësimit, Komisioni përfundoi analizën financiare për këtë pasuri.

Të ardhura nga punësimi 5 muaj 2003, Skënder Haluci	0
Të ardhura nga punësimi 5 muaj 2003, A.S.	37,602
Të ardhura nga shitja e dyqanit Rr. “***”	1,900,000
Total të ardhura	1,937,602
Shpenzime jetese	105,710
Kosto ndërtim objekti në Rr. “***”	289,940
Shlyer kredi tek UBA	4,705,190

Paguar këst për apartamentin Rr. “***”, 5 muaj	291,667
Paguar për blerjen e apartamentit Rr. “***”, datë 22.5.2003	1,600,000
Total shpenzime	6,992,507
Pamundësia financiare	-5,054,904

Komisioni, lidhur me këtë pasuri, arriti në përfundimin se:

- Subjekti deklaroi që çmimi i vendosur në kontratë për blerjen e apartamentit është favorizues. Këtë fakt, subjekti e arsyetoi me pretendimin se janë kryer disa veprime juridike, të cilat janë finalizuar me dy kontrata shitblerjeje pasurie të paluajtshme dhe një transaksion bankar.
- Subjekti pranoi se vlera e kontraktuar për apartamentin në Rr. “***”, nuk është vlera reale e tij.
- Deklarimet e subjektit për shkëmbim të pasurive nuk janë provuar me dokumentacion shkresor. Rezultoi se për të tria pasuritë e deklaruara si të shkëmbyera nuk provohen veprimet juridike, të kryera konform legjislacionit shqiptar, por secila nga këto pasuri është finalizuar përmes kontratave të shitblerjes, ku përcaktohen edhe vlerat e blerjeve përkatëse.
- Subjekti nuk vërtetoi të ardhurat e pretenduara të bashkëshortes nga punësimi te gazeta “***”.
- Subjekti nuk vërtetoi të ardhura të ligjshme nga aktiviteti “***”, të cilat subjekti i pretendoi si burim për shlyerjen e kredisë tek UBA. Këto të ardhura, subjekti nuk i ka deklaruar as në deklaratat periodike vjetore të paraqitura në ILDKPKI, as në deklaratën “Vetting”.
- Subjekti rezultoi në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie në shumën prej - 5,054,904 lekësh.
- Në analizën financiare të kësaj pasurie, është marrë parasysh edhe vlera e deklaruar dhe vërtetuar me vërtetimin e shoqërisë “***” për pagesën e këstit të apartamentit në Rr. “***”, në vlerën prej 700,000 lekësh. Vlera përpjesëtimore që i takon pesë muajve të parë të vitit i është shtuar shpenzimeve të bëra para blerjes së pasurisë nga subjekti, me adresë në Rr. “***”.

8. Apartament me sip. 65 m², Rr. “*”, Tiranë, blerë në vlerën 3,000,000 lekë, me kontratë sipërmarrjeje datë 11.11.2000, në proces hipotekimi e likuiduar.**

Burimi i krijimit: të ardhurat personale nga paga.

Konstatimi i ILDKPKI-së

Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar. ZVRPP-ja Tiranë nuk e konfirmon pasi është me kontratë sipërmarrjeje dhe e paregjistruar.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Rezultoi se bashkëshortja e subjektit ka lidhur kontratë porosie në datën 11.11.2000, për blerje pasurie apartament me sip. 65 m², në vlerën 3,000,000 lekë.

Për këtë pasuri, subjekti dhe bashkëshortja nuk janë pajisur me certifikatë pronësie dhe nuk rezultoi konfirmim nga ZVRPP-ja Tiranë për regjistrimin e saj.

Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti edhe në deklaratën periodike vjetore për vitin 2004, “apartament me sip. 55 m², Rr. “***”, në vlerën e blerjes prej 27,000 USD”.

Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2004, subjekti ka deklaruar marrjen e një kredie në shumën prej 40,000 USD. Sipas kontratës së kredisë, kjo shumë është marrë për blerje apartamenti, por në këtë deklaratë periodike vjetore nuk është deklaruar pasuria e paluajtshme e blerë prej tij.

Në vitin 2004 rezultoi se është marrë hua nga subjekti në “Intesa Sanpaolo Bank”, vlera prej 40,000 USD. Subjekti është pyetur lidhur me këtë pasuri dhe ka deklaruar se kredia e marrë në vlerën prej 40,000 USD, ka shërbyer për shlyerjen e këtij apartamenti. Lidhur me këtë veprim rezultoi dhe një transfertë bankare e bërë në datën 16.2.2004, në vlerën prej 39,064 USD.

Për këtë është pyetur subjekti dhe ka deklaruar se: “...sipas kontratës së kredisë bankare nr. ***, datë 11.2.2004, kjo kredi është marrë nga ana jonë në ‘American Bank of Albania-Banka Amerikane e Shqipërisë’, sot ‘Intesa Sanpaolo Bank’, për blerjen e një apartamenti, kredimarrëse sipas kësaj kontrate ka qenë bashkëshortja ime A.S., ndërsa unë bashkëkredimarrës. Kjo shumë është përdorur prej saj për blerjen e një apartamenti, ashtu siç është deklaruar dhe konkretisht, për blerjen e një apartamenti të prenotuar më parë në shoqërinë (TID) ‘****’ sh.p.k. ***, me sip. 65 m², në të cilin banojnë prindërit e bashkëshortes. Kjo kredi është likuiduar totalisht në fund të vitit 2018. Banesa nuk është regjistruar akoma në emër të bashkëshortes time, pasi janë duke u kryer kalimet nga vërtetime pronësie në certifikata prone nga shoqëria ndërtuese”.

Deklarimi i subjektit nuk përkon me veprimet e kryera dhe provat e administruara nga Komisioni, pasi sipas kontratës së porosisë, vlera për blerjen e kësaj pasurie është në shumën 3,000,000 lekë, ku një pjesë prej 1,000,000 lekësh është paguar nga bashkëshortja e subjektit me lidhjen e kontratës në vitin 2003.

Gjithashtu, bazuar në vërtetimin e datës 12.1.2017, të lëshuar nga administratori i shoqërisë “****” (dokument i administruar në dosjen e ILDKPKI-së), rezultoi se vlera e apartamentit të blerë nga bashkëshortja e subjektit është caktuar në shumën 3,000,000 lekë dhe se kjo shumë është likuiduar tërësisht me këste nga viti 2000 deri në vitin 2003.

Pra, rezultoi se kemi të bëjmë ose me deklaram të pasaktë nga subjekti, ose vlera e pasurisë së blerë nuk është deklaruar e plotë në kontratën e porosisë së lidhur nga palët.

Bazuar në analizën financiare të hartuar nga Komisioni, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka qenë në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie dhe në mungesë të burimeve të ligjshme në vlerën prej -5,112,236 lekësh.

Konkluzion i Komisionit në përfundim të hetimit

- Bazuar në analizën financiare, subjekti është në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie.
- Subjekti ka bërë deklarata kontradiktore lidhur me vlerën e blerjes së kësaj pasurie, veprimeve të kryera dhe destinacionit të kredisë së marrë.
- Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë lidhur me vlerën e blerjes së kësaj pasurie të paluajtshme.
- Kjo pasuri nuk është regjistruar akoma në ZVRPP, duke shmangur kështu pagimet e detyrimeve në buxhetin e shtetit që vijnë nga blerja e kësaj pasurie.

Për të gjitha gjetjet e mësipërme, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

Në përgjigje të rezultateve, subjekti në mënyrë të përmbledhur ka deklaruar:

“- Ky apartament, i cili është pikërisht apartamenti për të cilin është marrë kredia dhe në deklarin periodik të vitit 2004, kur kam deklaruar kredinë e marrë për blerje apartamenti, kam deklaruar edhe apartamentin.

- Kjo pasuri është prenotuar për t’u blerë nga bashkëshortja ime me kontratën e sipërmarrjes datë 11.11.2000, mes saj dhe shoqërisë ‘***’ sh.p.k. në të cilën është parashikuar se vlera e kësaj pasurie është 3,000,000 lekë dhe pagesa do të bëhet: ‘1,000,000 do të paguhet me lidhjen e kontratës dhe 2,000,000 lekë do të paguhet me marrjen e dokumenteve të pronësisë’.

- Diferenca e konstatuar nga ana juaj është e drejtë dhe ka ardhur si pasojë e faktit se në vitin 2004 e kam deklaruar 27,000 USD, pasi nuk e kam pasur në dispozicion kontratën e sipërmarrjes që bashkëshortja ime ka lidhur me firmën e ndërtimit dhe për plotësimin e formularit i jam referuar vetëm deklarinimeve të saj, e cila më ka referuar këtë shumë me përparësi, ndërsa, në deklaratën ‘Vetting’ shuma 3,000,000 lekë, është plotësuar nga bashkëshortja duke iu referuar përmbajtjes së kontratës, pasi para se ta plotësonte ka mbledhur dokumentacionin përkatës.

- Po të shihet deklarimi, pasuria është apartament, pallati ***, sip. 55 m², data e krijimit viti 2000, kam ngatërruar vetëm rrugën dhe sipërfaqen, në vend ta shkruaja ‘***’ e kam shkruar ‘***’ (ndoshta ka ndryshuar emri i rrugës).

- Nuk kam bërë deklarime kontradiktore në lidhje me këtë pasuri. Në deklaratën ‘Vetting’ kjo pasuri nuk është deklaruar nga ana ime, por nga bashkëshortja në pjesën e deklaratës të cilën e plotëson personi i lidhur.

- Destinacioni i kredisë ka qenë pikërisht shlyerja e pjesës së mbetur të vlerës së këtij apartamenti, pasi 1,000,000 lekë ishin shlyer nga bashkëshortja në momentin e lidhjes së kontratës dhe pjesa tjetër sipas vërtetimit të lëshuar nga shoqëria ‘***’. Sqarojmë se pjesa tjetër është përdorur për mobilimin e shtëpisë dhe duke qenë se kjo ka qenë një kredi tregtare, pra, jo me interesa favorizuese dhe për sa kohë është shlyer nuk besoj se përbën problem destinacioni i saj në mënyrë të detajuar, megjithëse në pjesën dërmuese të saj kjo kredi është përdorur për blerjen dhe mobilimin e kësaj shtëpie.

- Regjistrimi në ZRPP nuk është bërë për shkak të moshipotekimit të objektit nga ana e shoqërisë ndërtuese dhe nuk ka lidhje me shmangien e detyrimeve në buxhetin e shtetit”.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe përgjigjes së subjektit të rivlerësimit, Komisioni përfundoi analizën financiare për këtë pasuri.

Analiza e pasurisë apartament me sip. 65 m², Rr. “**” Tiranë, blerë në vlerën 3.000.000 lekë, datë 11.11.2000, 100 %, në pronësi të bashkëshortes së subjektit, znj. A.S.**

Përshkrimi	10 muaj 2000	2001	2003	2004
Të ardhura nga punësimi, Skënder Haluci	24,381	206,802	336,184	1,056,992
Të ardhura nga punësimi, A.S.	66,319	88,063	105,249	146,986
Te ardhura nga shitja e apartamentit, Rr. “****”			1,900,000	
Kredi e marrë te “Intesa Sanpaolo Bank”				3,783,200
Total të ardhura	90,700	294,865	2,341,433	4,987,178
Shpenzime jetese	270,000	302,796	281,892	281,892
Kosto ndërtim objekti në Rr. “****”	644,312	773,174	773,174	773,174

Blerë apartamenti në Rr. « *** » - 2003			1,600,000	
Shpenzime mobilimi apartamenti Rr. «****»				2,983,200
Paguar këst për apartamentin Rr. «****» 2000 – 2004	1,000,000	500,000	700,000	800,000
Shpenzime familjare deklaruar 4,000 USD – 2004				506,960
Shpenzime udhëtimi				78,579
Shlyer kredi tek UBA			4,705,190	
Shlyer kredi tek “Intesa Sanpaolo Bank”				510,531
Total shpenzime	1,914,312	1,575,970	8,060,256	5,934,336
Pamundësia financiare	-1,823,612	-1,281,105	-5,718,823	-947,158

Komisioni, lidhur me këtë pasuri, arriti në përfundim se:

- Subjekti pranoi pasaktësinë në deklaram lidhur me vlerën e apartamentit (27,000 USD/ 3,000,000 lekë) me pretendimin e mungesës së dokumenteve në momentin e deklaramit periodik në vitin 2004, ndonëse kontrata e sipërmarrjes është lidhur në vitin 2000.
- Subjekti nuk provoi me dokumentacion shkresor se kredinë e marrë te Banka Amerikane në vitin 2004 e ka përdorur si burim për blerjen e këtij apartamenti.
- Subjekti nuk paraqiti dokumentacion bindës nga shoqëria ndërtuese “****” për vërtetimin e kohës së pagesës të vlerës së blerjes së apartamentit. Bazuar në vërtetimin e parë të shoqërisë “****”, pagesa është shlyer krejtësisht deri në vitin 2003. Sipas vërtetimit të sjellë, në përgjigje të rezultateve të hetimit, shoqëria ndërtimore konfirmon se shlyerja e vlerës së apartamentit shtrihet në periudhën 2000 – 2004. Pra, rezultuan dy vërtetime të ndryshme lidhur me periudhën e shlyerjes së detyrimit për këtë pasuri.
- Subjekti pretendon se me kredinë e marrë te Banka Amerikane ka kryer edhe shpenzime mobilimi të apartamentit, por pa paraqitur dokumentacion provues. Megjithatë, lidhur me këto shpenzime, Komisioni mori në konsideratë përgjigjet e subjektit dhe i pasqyroi në analizën financiare.
- Subjekti rezultoi në mungesë të burimeve të ligjshme financiare për blerjen e kësaj pasurie gjatë viteve 2000, 2001, 2003 dhe 2004, përkatësisht në vlerat -1,823,612 lekë, -1,281,105 lekë, -5,718,823 lekë, dhe -947,158 lekë. Në total, pamundësia financiare arrin një vlerë prej -9,770,698 lekësh.

9. Gjendje cash e bashkëshortes së subjektit, znj. A.S., në vlerën 1,500,000 lekë.

Bashkëshortja e subjektit ka deklaruar në deklaratën “Vetting” gjendje cash jashtë sistemit bankar në vlerën 1,500,000 lekë.

Konstatimi i ILDKPKI-së

Të ardhurat e realizuara mundësojnë krijimin e gjendjes cash të deklaruar.

Kjo çështje është trajtuar më lart, në pikën 6 të këtij vendimi.

10. Gjendje cash e vajzës së subjektit, znj. A.H., në vlerën 1,500,000 lekë.

Vajza e subjektit ka deklaruar në deklaratën “Vetting” gjendje cash jashtë sistemit bankar në vlerën 1,500,000 lekë.

Burimi i krijimit: të ardhurat e prindërve.

Konstatimi i ILDKPKI-së

Të ardhurat e realizuara mundësojnë krijimin e gjendjes cash të deklaruar.

Kjo çështje është trajtuar më lart, në pikën 6 të këtij vendimi.

11. Financim burse në vlerën 181,478 USD, bursë e përfituar nga vajza e subjektit, znj. A. H, në *** College në vitet 2014 - 2017.

Konstatimi i ILDKPKI-së

Subjekti ka paraqitur tri fatura për vitet akademike 2014 – 2015 – 2016.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Në përgjigje të pyetësorit të dërguar nga Komisioni, subjekti ka deklaruar shpenzime për shkollimin e vajzës për vitet 2014 - 2017, pranë *** College në shumën totale prej 15,000 USD.

Sipas vërtetimeve të *** College, të ndodhura në dosjen e ILDKPKI-së (fotokopje në gjuhën angleze) rezultoi se për vitet 2014 - 2017, subjekti ka paguar si kontribut gjithsej, vetëm vlerën prej 15.000 USD (5000 USD për çdo vit përkatës).

Në deklaratat periodike vjetore rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë deklaram të saktë lidhur me shpenzimet për shkollimin e vajzës dhe pagesën e kontributit financiar prindëror.

Në deklaratën periodike për vitin 2014, subjekti ka deklaruar shpenzime në vlerën 2,500 USD, kurse për vitet 2015 - 2016 ka deklaruar shpenzime në vlerën prej 3,000 USD për secilin vit.

Lidhur me vërtetimin e deklarimeve, subjekti është pyetur dhe i është kërkuar paraqitja e dokumentacionit shkresor provues për vërtetimin e pagimit të detyrimeve të bursës nga kolegji, si dhe evidentimin e saktë të shpenzimeve të mbuluara nga subjekti, sipas legjislacionit shqiptar. Komisioni, deri në përfundim të rezultateve të hetimit, nuk mori përgjigje nga subjekti për këtë çështje.

Subjekti i rivlerësimit ka qenë në pamjaftueshmëri të deklaramit të të gjitha shpenzimeve të jetesës të kryera për vajzën.

Gjithashtu, për shkak se subjekti nuk kishte paraqitur dokumentacion bindës përpara Komisionit iu kërkuar të provonte:

- vlerën totale të shkollimit, pagesat e kryera, kontributin për shkollën, si dhe burimin e ligjshëm;
- çfarë përfshin bursa e pretenduar si e përfituar nga shkolla;
- vlerat e shpenzimeve mujore (shpenzime jetese, strehimi, ushqimi etj.) pagesat e kryera, si dhe burimin e ligjshëm.

Në analizën financiare u përfshi si shpenzim shuma e paguar prej 181,478 USD, si dhe kontributi i deklaruar për tarifatat e shkollës në vlerat 5,000 USD në vit, pasi subjekti nuk kishte paraqitur dokumentacion shkresor provues sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Konkluzion i Komisionit në përfundim të hetimit

- Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë dhe dokumentojë burimin e ligjshëm për shkollimin e vajzës, si dhe të gjitha shpenzimet e kryera gjatë viteve të shkollimit 2014 – 2016.
- Deklarimet e subjektit, lidhur me pagesat e shkollës dhe shpenzimet e kryera, janë të paqarta dhe të pasakta.

- Subjekti nuk ishte bindës lidhur me deklaratimet e shpenzimeve të jetesës së vajzës në deklaratat periodike vjetore për vitet 2014 – 2017.

Për të gjitha gjetjet e mësipërme, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

Në përgjigje të rezultateve, subjekti, në mënyrë të përmbledhur ka deklaruar:

*“- Kam sqaruar se vajza ime është trajtuar me bursë të plotë nga *** College në këto vite dhe ju kam dërguar vërtetimet e përkthyer dhe të noterizuara në lidhje me përfitimin e bursës nga vajza ime. Këto dokumente nuk i kam sjellë me vulë apostile, pasi kam gjykuar se janë mjaftueshmërisht të besueshme dhe besoj se jo gjithmonë të gjithë subjektet e kanë sjellë dokumentacionin me vulë apostile dhe në praktikën tuaj vendimmarrëse kam vënë re se keni pranuar edhe dokumentacion, që vjen nga jashtë shtetit edhe pa vulë apostile.*

- Për këtë i kam kërkuar vajzës time që të më sjellë këtë dokumentacion me vulë apostile nga SHBA-ja dhe ajo më ka informuar se dokumentacioni i është nisur nga kolegji me postë dhe me e-mail dhe sapo ky dokumentacion të arrijë në adresën e saj, ajo do të aplikojë për vulë apostile dhe do i nisë në adresën time me postë të shpejtë. Për sa më sipër, kërkoj mirëkuptimin tuaj duke pritur kohën e nevojshme për mbërritjen e këtij dokumentacioni, duke më dhënë afat shtesë për marrjen e këtij dokumentacioni, duke mbajtur parasysh vonesat e postës brenda për brenda në SHBA dhe procedurën për marrjen e vulës apostile.

- Për sa i përket shpenzimeve të përballuara nga ana jonë, besoj se kam qenë i qartë në deklaratën ‘Vetting’ duke mbajtur parasysh se këto shpenzime nuk janë bërë në mënyrë të menjëhershme dhe nuk janë bërë vetëm nga unë, por edhe nga bashkëshortja”.

Komisioni, lidhur me këtë pasuri, arriti në përfundim se:

- Komisioni mori në konsideratë përgjigjen e subjektit dhe dokumentacionin e paraqitur lidhur me shpenzimet e shkollimit të vajzës.
- Në analizën financiare është zbritur vlera e shpenzimit prej 181,478 USD, pasi subjekti paraqiti dokumentacion provues se kjo shumë është përfituar si bursë nga shkolla.
- Subjekti nuk ka dhënë shpjegime të plota lidhur me shpenzimet e tjera të vajzës gjatë periudhës së studimeve në SHBA. Nga përmbajtja e dokumentit që vërteton bursën e përfituar nga universiteti në SHBA, nuk është e qartë se çfarë mbulon bursa dhe se sa kanë qenë të gjitha shpenzimet e jetesës.
- Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratat periodike vjetore të dorëzuara në ILDKPKI, lidhur me shpenzimet e kryera për shkollimin e vajzës.

12. Financim burse në vlerën 30,000 euro. Bursë e përfituar nga vajza e subjektit, znj. A.H., në * COLLEGE *** 2012 – 2014, *** IN ***.**

Konstatimi i ILDKPKI-së

*Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, në lidhje me bursën e përfituar nga znj. A. H., në *** COLLEGE *** 2012 – 2014, *** IN ***.*

Hetimi i kryer nga Komisioni

Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar financim burse në vlerën prej 30,000 euro, e përfituar për shkollimin e vajzës në *** College *** për vitet 2012 - 2014.

Lidhur me këtë deklaram, por edhe në përgjigje të pyetësorit të dërguar nga Komisioni, subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion provues lidhur me vërtetimin e përfitimit të kësaj burse, si dhe burimin e ligjshëm.

Në përgjigje të pyetësorit të dërguar nga Komisioni, subjekti ka deklaruar shpenzime për shkollimin e vajzës për vitet 2012 - 2014 në *** College ***, në shumën totale prej 4,800 euro. Rezultoi se në deklaratat periodike për vitin 2012 dhe 2013, nuk ka deklaruar shpenzime për shkollimin e vajzës. Këto shpenzime nuk janë deklaruar nga subjekti as në deklaratën “Vetting”.

Subjekti nuk arriti të përcaktojë saktë, provojë dhe dokumentojë vlerën e të gjitha shpenzimeve të kryera për shkollimin e vajzës, në vitet 2012 – 2014.

Subjekti nuk arriti të paraqesë dokumentacion bindës përpara Komisionit lidhur me:

- vlerën totale të shkollimit, pagesat e kryera, kontributin për shkollën, si dhe burimin e ligjshëm;
- çfarë përfshin bursa e pretenduar si e përfituar nga shkolla;
- vlerat e shpenzimeve mujore (shpenzime jetese, strehimi, ushqimi, etj.) pagesat e kryera, si dhe burimin e ligjshëm.

Gjithashtu, subjektit iu kërkua edhe paraqitja e dokumentacionit të nevojshëm për përfitimin e bursës prej 30,000 USD, sipas rregullave të legjislacionit shqiptar. Komisioni, deri në dërgimin e rezultateve të hetimit, nuk arriti të marrë përgjigje nga subjekti për këtë çështje.

Konkluzion i Komisionit në përfundim të hetimit

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë dhe dokumentojë burimin e ligjshëm për shkollimin e vajzës, si dhe të gjitha shpenzimet e kryera gjatë viteve të shkollimit për vitet 2012 – 2014.
- Deklarimet e subjektit lidhur me pagesat e shkollës dhe shpenzimet e kryera janë të paqarta dhe të pasakta, si dhe ka mosdeklarime të shpenzimeve të kryera në deklaratat periodike vjetore.
- Subjekti nuk ka qenë bindës lidhur me deklaratimet e shpenzimeve të jetesës së vajzës në deklaratat periodike vjetore për vitet 2012 - 2014.

Për të gjitha gjetjet e mësipërme, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

Në përgjigje të rezultateve, subjekti, në mënyrë të përmbledhur ka deklaruar: *“Bëj të qartë se tashmë kemi arritur të marim dokumentacionin me vulë apostile, i cili sqaron faktet e dërguara më parë, në lidhje me këtë shpenzim. Besojmë se dokumentacioni bashkëlidhur në lidhje me trajtimin me bursë të vajzës time, tashmë me vulë apostile, i përkthyer dhe noterizuar vërteton plotësisht dhe heq çdo dyshim në lidhje me përfitimin e kësaj burse, dhe besoj tashmë se edhe ju, si Komision, do të bindeni plotësisht edhe në lidhje me këtë fakt”.*

Komisioni, lidhur me këtë pasuri, arriti në përfundimin se:

- Subjekti ka paraqitur me dokument provues, sipas legjislacionit shqiptar për pagesën e shkollës përmes bursës së përfituar dhe kontributit prindëror. Pjesa e vërtetuar e bursës së përfituar është zbritur nga shpenzimet në analizën financiare.

- Subjekti nuk paraqiti dokumentacion të plotë provues lidhur me të gjitha shpenzimet e jetesës dhe shpenzime të tjera të kryera nga vajza, znj. A.H., për periudhën e studimeve për vitet 2012 – 2014.
- Deklarimet e subjektit, lidhur me pagesat e shkollës dhe shpenzimet e kryera, janë të paqarta dhe të pasakta, si dhe ka mosdeklarime të shpenzimeve të kryera në deklaratat periodike vjetore.
- Subjekti nuk ka qenë bindës lidhur me deklaratimet e shpenzimeve të jetesës së vajzës në deklaratat periodike vjetore për vitet 2012 - 2014.

13. Shpenzimet e vajzës së subjektit të rivlerësimit

Në përgjigje të pyetësorit, subjekti ka deklaruar shpenzime për shkollën verore të vajzës në Mbretërinë e Bashkuar, në vlerën prej 3,000 GBP. Këtë shpenzim, subjekti nuk e ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore për vitin 2012, të paraqitur në ILDKPKI dhe as në deklaratën “Vetting”.

Subjekti, gjatë fazës së hetimit të kryer nga Komisioni, nuk ka provuar me dokumentacion shkresor që shpenzimet e kryera për shkollën verore janë në shumën totale prej 3,000 GBP.

Komisioni krijoi bindjen se vlera e deklaruar prej 3,000 GBP nuk përcakton qartë nëse ka të bëjë me kontributin për pagesën e shkollës apo për të gjitha shpenzimet e tjera së bashku, duke përfshirë edhe shpenzimet e jetesës, akomodimit, ushqimit, etj.

Komisioni i kërkoi subjektit dokumentacion bindës për pagesat e kryera, si dhe të gjitha shpenzimet e kryera për të gjithë periudhën e shkollës verore dhe qëndrimit të vajzës në Mbretërinë e Bashkuar.

Për të gjitha gjetjet e mësipërme, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat, për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

Në përgjigje të rezultateve, subjekti, në mënyrë të përmbledhur ka deklaruar:

“ - Ky shpenzim nuk është deklaruar në deklaratën periodike dhe as në atë ‘Vetting’, për shkak se këto shpenzime janë përballuar dhe nga unë dhe nga bashkëshortja dhe janë paguar në rrugë bankare nga ana e bashkëshortes, në fakt, në shumën prej 3,300 GBP për faktin se të përballuara veç e veç, në gjykimin tim, nuk e kalonin limitin tim prej 300, 000 lekësh, të detyrueshëm për deklarim. Gjithashtu, edhe vlera nuk është deklaruar e plotë edhe në pyetësor, pasi nuk e zotëroja dokumentacionin e saktë, por jam munduar të jem i sigurtë në pyetësor, duke treguar me përafërsi shumën prej 3,000 GBP.

- Bashkëngjitur keni programin e kësaj shkolle verore, certifikatën e marrë nga vajza ime, si dhe pagesën në rrugë bankare të këtij shpenzimi”.

Komisioni, lidhur me këtë pasuri, arriti në përfundim se:

- Subjekti pretendoi se këto shpenzime nuk janë deklaruar në deklaratën periodike vjetore, sepse janë bërë përmes pagesave të veçanta gjatë vitit dhe asnjë prej tyre nuk e kalonte vlerën 300,000 lekë. Ndërkohë, sipas provës dokumentare që ka sjellë subjekti, rezultoi se transferata bankare e bërë për këtë universitet nga bashkëshortja është bërë me një pagesë të vetme prej 3,300 GBP, datë 29.5.2012. Te përshkrimi i transfertës, duket qartë se pagesa mbulon vetëm vlerën e studimeve. Pra, rezultoi se subjekti nuk ka qenë i saktë në deklaratimet për këto shpenzime.

- Subjekti nuk ka dhënë shpjegime lidhur me shpenzimet e tjera të vajzës gjatë periudhës së studimeve në Mbretërinë e Bashkuar.
- Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë dhe nuk ka vërtetuar vlerën e të gjitha shpenzimeve të kryera për shkollim veror të vajzës.

14. Pasuria “Bar-Kafe”, Rr. “**”.**

Sipas kontratës së shitjes ka rezultuar se subjekti ka shitur në vitin 2003, një objekt “****” në Rr. “****”. Vlera e kontratës është deklaruar në shumën 1,900,000 lekë. Po në këtë vit, subjekti ka deklaruar dhe ka rezultuar se është paguar plotësisht kredia e marrë dhe vlera e mbetur në UBA (ish-Banka Arabe Shqiptare Islamike), në shumën prej 34,965 USD. Lidhur me pagesën e këtij detyrimi ka deklaruar se burimi i plotë për shlyerjen e vlerës së kredisë janë të ardhurat e përfituara nga shitja e objektit bar-kafe.

Pra, rezultoi se ka mospërputhje midis deklarimeve të subjektit lidhur me vlerën e shitjes, vlerën e përcaktuar në kontratë, kredinë e përfitur dhe përdorimin e saj, si dhe veprimet bankare për shlyerjen e kredisë.

Komisioni ka pyetur subjektin lidhur me mosrakovordin e vlerës së shitjes prej 1,900,000 lekësh dhe shlyerjes së detyrimit ndaj bankës në vlerën 34,965 USD, i cili ka deklaruar se: *“...siç e kam deklaruar edhe më parë, kam marrë nga ‘Banka Arabe Shqiptare Islamike’ sh.a. me seli në Tiranë, në Bulevardin ****, nr. ****, datë 28.1.2002 një kredi në shumën 50 000 USD, detyrim i cili është shlyer përfundimisht me datën 22.5.2003, pasi e kam shitur dyqanin e ndodhur në Rr. ‘***’ Tiranë. Burimi i krijimit të kësteve të paguara ka qenë paga dhe kursime nga puna, si dhe aktiviteti im në këtë lokal. Kësti i fundit në vlerën prej 34.965 USD është shlyer nga blerësi i dyqanit tim (Bar-Kafe “****”) të ndodhur në Rr. ‘****’ z. F.V., të cilit ia kam shitur dyqanin pasi ka shlyer detyrimin tim që kisha ndaj UBA-s. Pagesa prej 34.965 USD përfshihej në vlerën e dyqanit (Bar-Kafe “****”) në Rr. ‘****’ (ish- bllok) Tiranë.*

*Ju sqaroj se pasi jam njohur me shtetasin F.V., në lokalit në pronësinë time (Bar-Kafe “****”) në Rr. ‘****’ Tiranë, pas kërkesës së tij kam vendosur që t’ia shes lokalit. Me shtetasin F.V., ramë dakord që unë t’i jepja lokalit në Rr. ‘****’ dhe ai të shlyente detyrimin që kisha në UBA, pasi e dinte se pa u shlyer pjesa e mbetur e detyrimit që kisha ndaj bankës, shitja nga ana ime ishte e pamundu, pasi objekti për efekt të kredisë së sipërcituar ishte në hipotekë sipas marrëveshjes se hipotekimit nr. ****, datë 28.1.2002, me përfitues Bankën Arabe Shqiptare Islamike. Z. F.V., mori përsipër shlyerjen e menjëhershme të kësaj kredie. Pasi është bërë pagesa, shlyerja e kredisë nga shtetasi F.V., është lëshuar deklarata noteriale për lirim hipoteke nr. ****, datë 22.5.2003 nga banka dhe është bërë regjistrimi i kësaj prone në emër të tij”.*

Konkluzion i Komisionit në përfundim të hetimit

- Lidhur me këtë pasuri rezultoi se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë.
- Nuk përkoi vlera e blerjes së kësaj pasurie bazuar në kontratën e shitblerjes dhe deklarimeve të bëra nga subjekti.
- Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë lidhur me burimin e ligjshëm të shlyerjes së vlerës së kredisë prej 34.965 USD.

Bazuar në analizën financiare, subjekti ka qenë në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie në vitin 1998, në shumën prej -10,422,463 lekësh.

Për të gjitha gjetjet e mësipërme, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat, për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

Në përgjigje të rezultateve, subjekti, në mënyrë të përmbledhur ka deklaruar:

“ - Kam blerë pasurinë e llojit dyqan, të ndodhur në katin përdhe në rrugën ‘***’ kundrejt vlerës 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) USD. Këtë dyqan e kam vendosur në hipotekë në favor të UBA-s për efekt të kredisë së marrë në vlerën 50.000 USD.

- Këtë e kam sqaruar njësoj si për pasurinë më sipër ‘apartament me sip. 106 m², në Rr. ‘***’, Tiranë.

- Për të provuar këtë keni edhe deklaratë noteriale nga shtetasi F.V., me anë të së cilës ai konfirmon këtë marrëdhënie mes nesh.

- Në analizën financiare nuk meret parasysh fakti se shuma prej 34.965 USD është shlyer nga shtetasi F.V.

- Po kështu, në këtë analizë futet si shpenzim padrejtësisht shuma prej 60,000 euro, si likuidim i lokalit kur ky likuidim është bërë me kredisë e marrë në vitin 2002, ndërkohë që likuidimi i kredisë është bërë në vitin 2003, një pjesë nga të ardhurat e lokalit dhe pjesa e mbetur nga blerësi F.V.

- Gjithashtu, në këtë analizë futet padrejtësisht shuma prej 2,319,523 lekësh për ndërtim shtëpie në Rr. ‘***’ kur e gjithë shuma e shpenzuar për ndërtimin e kësaj shtëpie deri në ditën e sotme, megjithë riparimet e bëra nuk e kalon masën e 2,000,000 lekëve, gjë që besoj se provohet nga raporti i vlerësimit të hartuar nga ekspertja.

- Në analizat tuaja financiare asnjëherë nuk janë marrë parasysh të ardhurat reale të bashkëshortes time bazuar në vërtetimet e punëdhënësve”.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe përgjigjes së subjektit të rivlerësimit, Komisioni përfundoi analizën financiare për këtë pasuri.

Analiza e pasurisë dyqan me sip. 65.6 m², në Rr. “*”, blerë në vlerën 60,000 USD, datë 30.12.98, 100 %, në pronësi të subjektit, z. Skënder Haluci**

Të ardhura nga punësimi 1996 – 1998, Skënder Haluci	695,929
Të ardhura nga punësimi 1996 – 1998, A.S.	63,723
Total të ardhura	759,652
Shpenzime jetese	487,192
Kosto ndërtim objekti në Rr. “***”	773,174
Paguar 60.000 euro për dyqanin Rr. “***”	8,375,400
Total shpenzime	9,635,766
Pamundësia financiare për blerje pasurie	-8,876,115

Komisioni, lidhur me këtë pasuri, arriti në përfundim se:

- Subjekti nuk vërtetoi me dokumentacion të ardhurat e pretenduara të bashkëshortes nga punëdhënësi, gazeta “***”, për periudhën e blerjes së pasurisë.
- Subjekti nuk vërtetoi ligjshmërinë e pagesës së kredisë tek UBA, nga shtetasi F.V.

- Subjekti pranoi se vlera e shitjes së kësaj pasurie nuk është 1,900,000 lekë, sipas kontratës, por mbi këtë vlerë duhet shtuar edhe vlera e shlyerjes së kredisë tek UBA, 34,965 USD nga F.V. Përveç kësaj, këtu pretendoi edhe blerjen me çmim më të ulët të pasurisë në Rr. “***”, në vlerën 1,600,000 lekë.
- Llogaritja e kostos së ndërtimit është bërë për periudhën 1997 – 2005 (sipas deklarimeve të subjektit në pyetësor) për 1/3 e sipërfaqes së plotë të ndërtimit, bazuar kjo në bindjen e krijuar nga Komisioni. Në analizën financiare është përfshirë vlera e 1/3 të sipërfaqes totale të ndërtimit, sipas deklaramit të subjektit.
- Subjekti rezultoi në mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e pasurisë në vitin 1998, në vlerën - 8,876,115 lekë.

15. Automjet

Ka rezultuar se nga subjekti është blerë me kontratën nr. *** kol., datë 4.4.2012, edhe një automjet tjetër tip “Benz”, me targa AA ***, në vlerën prej 200,000 lekësh (këtu nuk janë përfshirë të dhënat për detyrimet doganore dhe taksat e tjera).

Ky automjet është shitur më pas në datën 6.1.2016, sipas kontratës nr. ***, në vlerën 500,000 lekë. Automjeti nuk është deklaruar si i blerë nga subjekti në deklaratën periodike vjetore për vitin 2012.

Në lidhje me këtë, subjekti ka deklaruar *se vlera e këtij automjeti është deklaruar në deklaratën “Vetting” dhe se për këtë automjet është investuar në vlerën totale prej 400,000 lekësh. Kjo pasuri, më pas, i është shitur vëllait të subjektit në vlerën 500,000 lekë dhe se subjekti nuk ka pasur detyrim ligjor për pagimin e tatimit mbi të ardhurat.*

Bazuar në analizën financiare rezultoi se subjekti ka qenë në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie në shumën prej -260,560 lekësh.

Për të gjitha gjetjet e mësipërme, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

Në përgjigje të rezultateve, subjekti, në mënyrë të përmbledhur ka deklaruar:

“ - Edhe në këtë rast nuk është mbajtur parasysh gjendja cash në vitin paraardhës, nuk janë mbajtur në konsideratë të ardhurat nga Federata Shqiptare e Futbollit të bashkëshortes time në shumën prej 80,000 lekësh në muaj, sipas vërtetimeve të pagave që ju i dispononi.

- Gjithashtu, llogaria juaj për shpenzimet bëhet deri në datën e blerjes së automjetit dhe jo deri në datën e shitjes, kur sipas logjikës, shpenzimet për mirëmbajtjen e tij bëhen pasi blihet dhe jo përpara, një fakt tjetër i vogël në dukje, por që tregon se analiza financiare është bërë gjithmonë në mënyrë të njëanshme me qëllim për të rënduar pozitën time”.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe përgjigjes së subjektit të rivlerësimit, Komisioni përfundoi analizën financiare për këtë pasuri.

Analiza financiare e pasurisë automjet tip “Benz” me targa AA *, blerë datë 4.4.2012, 100 %, në pronësi të subjektit, z. Skënder Haluci**

Të ardhura nga punësimi 3 muaj 2012, Skënder Haluci	266,232
Të ardhura nga punësimi 3 muaj 2012, A.S.	0
Total të ardhura	266,232

Shpenzime jetese 3 muaj	87,218
Shpenzime transporti Tiranë-Vlorë 3 muaj - Skënder Haluci	27,000
Shpenzime udhëtimi 3 muaj	12,575
Kosto blerjeje automjet tip Benz AA ***, datë 4.4.2012	400,000
Total shpenzime	526,792
Pamundësia financiare për blerje pasurie dhe shlyerje kredie	-260,560

Komisioni, lidhur me këtë pasuri, arriti në përfundimin se:

- Subjekti pretendoi se shpenzimet e mirëmbajtjes të bëra për automjetin, duhet të ishin shpërndarë në vitet pas blerjes deri në shitjen e tij. Por, ky qëndrim nuk përkon me qëndrimin e mbajtur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit, ku pretendoi se automjetin ia ka shitur pa letra të vëllait, menjëherë, pasi i ka plotësuar dokumentacionin dhe pas një shërbimi të bërë.
- Subjekti nuk vërtetoi me dokumentacion të ardhurat e pretenduara të bashkëshortes nga punëdhënësi, Federata Shqiptare e Futbollit dhe këto të ardhura nuk janë përfshirë në analizën financiare.
- Ky automjet nuk është deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të dorëzuar në ILDKPKI për vitin 2012, dhe as nuk provoi se burimi për blerjen e kësaj pasurie është nga gjendje *cash* e krijuar për atë vit. Saktësojmë se edhe në deklaratat periodike vjetore subjekti nuk ka deklaruar ndryshim të gjendjes *cash* (shtesa dhe pakësime).
- Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë dhe është në pamundësi financiare dhe burimi të ligjshëm për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2012, në vlerën prej -260,560 lekësh.

16. Të ardhurat e bashkëshortes nga marrëdhëniet e punës

Në deklaratën “Vetting” janë deklaruar të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga marrëdhëniet e punës:

- në gazetën “***”, në shumën totale prej 13,810,000 lekësh, për periudhën prill 1998 – korrik 2005;
- nga subjekti PDK, në shumën totale prej 960,000 lekësh, për periudhën korrik 2002 – korrik 2005;
- nga Federata Shqiptare e Futbollit në shumën prej 900,000 lekësh, për periudhën nga shtatori 2011 e në vazhdim;
- nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në shumën prej 1,795,781 lekësh, për periudhën mars 2014 – prill 2016.

Nga vërtetimi nr. *** prot., datë 8.2.2018, i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, konfirmohet se:

- pagat bruto të znj. A.S., te gazeta “****” për periudhën qershor 1998 – dhjetor 2001, nga të cilat në analizën financiare, janë llogaritur pagat neto;
- mungesa e emrit të znj. A.S., te listëpagesat e KQZ-së për periudhën korrik 2002 – korrik 2005;
- mungesa e emrit të znj. A.S., te listëpagesat e Federatës Shqiptare të Futbollit, për periudhën shtator 2011 – dhjetor 2012.

Rezultoi bazuar edhe në përgjigjen e Drejtorisë së Tatimeve nr. *** prot., datë 13.11.2019, se organet tatimore nuk vërtetojnë dot pagesën e tatimit në burim për të ardhurat që znj. A.S., pretendon të ketë përfituar nga këto subjekte private.

Subjekti nuk arriti të paraqesë dokumentacion provues lidhur me të ardhurat e bashkëshortes si burime të ligjshme, për të cilat janë paguar dhe detyrimet tatimore në buxhetin e shtetit.

Rezultoi se nga subjekti është bërë deklaram i pasaktë në deklaratën “Vetting”, lidhur me të ardhurat e përfituara nga marrëdhëniet e punës të bashkëshortes.

Për të gjitha gjetjet e mësipërme, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat, për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga e Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

Në përgjigje të rezultateve, subjekti, në mënyrë të përmbledhur ka deklaruar:

“ - Të gjitha deklaramet e bashkëshortes time janë bazuar në vërtetimet e punëdhënësve të saj dhe se pasqyrojnë të ardhurat reale të përfituara nga bashkëshortja ime si rezultat i punës së saj.

*- Qëndrimi juaj në lidhje me këto të ardhura është me dy standarde dhe më bën të dyshoj në lidhje me paanshmërinë tuaj në rezultatin e hetimit tim. Shikoni vendimin nr. ***, datë 5.2. 2019 dhe vendimin nr. ***, datë 26.6.2019.*

- Në raste të ngjashme, të ardhurat nga punësimi janë konsideruar të ligjshme nga ana juaj dhe në rastin e bashkëshortes time jo.

- Pasi më nxirrni një diferencë negative prej -105,113,687 lekësh, më duhet të them se kjo analizë është krejtësisht e gabuar, tërësisht e njëanshme, e fryrë, pa marrë parasysh gjendjen faktike duke konsideruar shpenzime të miat, shpenzime që nuk i kam bërë dhe duke mos konsideruar në mënyrë të plotë të ardhurat.

- Në këto analiza janë llogaritur padrejtësisht si shpenzime të miat, shpenzimet për shkollimin e vajzës, në total prej 181,478 USD dhe 30,000 euro, gjithashtu kosto e tokës dhe e banesës në mënyrë krejt arbitrare dhe në kundërshtim me qëndrimet e mëparshme nga 3,400,000 lekë kosto reale tokë, plus banesë nga ana juaj është llogaritur 20,875,706 lekë banesa dhe 37,945,600 lekë toka gjithsej, pra, mbi 58,000,000 lekë të reja.

- Po kështu, llogariten si shpenzime të miat edhe shuma prej 34.965 USD, paguar nga shtetasi F.V.

- Gjithashtu, në analizën tuaj financiare pothuajse zerohen të ardhurat e bashkëshortes time, të cilat kapin shumën mbi 20,000,000 lekë të reja.

- Pas këtyre parashtrimeve dhe provave të reja të paraqitura, kërkoj edhe njëherë nga ana juaj riçeljen e hetimit për të tria kriteret dhe riçeljen e këtij hetimi edhe për kriterin e pasurisë (bazuar në vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Rjakib Birjukov k. Ruisë §37)”.

Komisioni, lidhur me këtë pasuri, arriti në përfundim se:

- Subjekti nuk vërtetoi me dokumentacion të ardhurat e pretenduara të bashkëshortes nga disa punëdhënës. Gjithashtu, nuk paraqiti asnjë dokumentacion provues për të provuar deklaramet lidhur me këto të ardhura (kontratë pune me shoqëritë, kopje të borderove, listëpagesat e shoqërive, *statementet* bankare lidhur me kalimin e shumave përkatëse në llogaritë bankare, vërtetime nga institucionet shtetërore përgjegjëse për konfirmimin e këtyre të ardhurave dhe pagimin e detyrimeve përkatëse në buxhetin e shtetit, etj.).

17. Analiza financiare

Edhe për analizën financiare⁴ Komisioni, në përfundim të hetimit dhe pas kalimit të barrës së provës, konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të paraqesë prova dhe dokumentacion justifikues, për të provuar plotësisht të kundërtën e gjetjeve të konstatuara nga Komisioni.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe përgjigjes së subjektit të rivlerësimit, Komisioni përfundoi analizën financiare për këtë pasuri.

⁴Shihni analizën financiare të rezultateve të hetimit të dërguar subjektit të rivlerësimit

ANALIZA FINANCIARE

SUBJEKTI I RIVLERESIMIT: Skender M., Haluci																
	1996-2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
PASURI	16,503,277	3,084,043	1,565,996	1,056,234	1,663,936	1,789,601	2,020,863	-1,155,008	1,134,315	-232,834	1,397,380	1,246,760	477,888	38,104,149	382,410	59,263,610
Ap banimi Rr. **** 842m2, 3 kate+papafingo, 97-05	4,639,046	773,174	773,174	773,174												6,958,569
Dyqan 95,2m2 Rr. *** Skender Haluci 100% - 60,000\$	8,375,400															0
Apartament 106 m2 Rr. *** Shk.***. Ap.*** TR -A.S., - 1,600,000 lek		1,600,000														1,600,000
Apartament 65m2 Rr. *** TR - A.S., -100% - 3,000,000 lek	1,500,000	700,000	800,000													3,000,000
Autoveture Benz AA*** - 2013 - S.Haluci - 100%												400,000				400,000
Toke are 1,400m2 *** - Skender Haluci - 2015 - 100%														37,945,600		37,945,600
Autoveture Jaguar X TYPE -AA***- 2015 - Skender Haluci - 100%														450,000		450,000
Autoveture Benz AA*** blere 2012											400,000					0
Letra me vlere demshperblim per burgun politik tek Llogaria e Kursimeve	988,831															988,831
Toke are 890m2 - A.S., 100% blere 1999 - 1,000,000 lek	1,000,000															0
Ndryshim ne likuiditet		10,869	-7,179	283,059	1,663,936	1,789,601	2,020,863	-1,155,008	1,134,315	-232,834	997,380	846,760	477,888	-291,451	382,410	7,920,610
DETYRIME	5,103,735	-3,918,379	3,665,196	-145,488	-124,253	-120,765	-167,972	-166,757	-273,561	-289,458	-261,602	-351,950	-384,317	-444,297	-478,904	1,641,230
Kredi Banka Amerikane (Intesa San Paolo) 40,000\$ - 2004-2016 pag keste			3,665,196	-145,488	-124,253	-120,765	-167,972	-166,757	-273,561	-289,458	-261,602	-351,950	-384,317	-444,297	-478,904	455,874
Kredi Banka e Bashkuar e Shqiperise UBA 50,000\$ (Kestet 16.750\$ - 43.290\$)	5,103,735	-3,918,379														1,185,356
																0
PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	11,399,542	7,002,423	-2,099,201	1,201,721	1,788,189	1,910,366	2,188,835	-988,251	1,407,876	56,624	1,658,982	1,598,710	862,205	38,548,447	861,314	57,622,380
TE ARDHURA dokumentuar	1,645,237	2,341,433	6,203,978	1,203,121	1,063,206	1,126,873	2,517,989	3,195,892	1,589,365	1,048,317	809,060	1,131,305	2,157,900	2,207,502	1,932,951	30,174,130
Te ardhura nga puna Skender Haluci	1,151,263	336,184	1,056,992	1,051,571	1,063,206	1,126,873	1,317,989	1,595,892	1,189,365	1,048,317	809,060	1,131,305	1,350,887	1,373,919	1,377,766	16,980,589
Te ardhura nga puna bashkeshortja A.S.,	493,974	105,249	146,986	151,550	0	0	1,200,000	1,600,000	400,000	0	0	0	807,013	833,583	155,185	5,893,541
Te ardhura nga shitja e tokes are 890m2 2004			5,000,000													5,000,000
Te ardhura nga shitja e dyqanit Rr. *** 2003		1,900,000														1,900,000
Te ardhura nga shitja e makines														400,000		400,000
SHPENZIME	2,085,369	1,068,703	9,243,158	783,049	847,636	1,258,395	1,616,864	1,412,009	857,431	648,810	1,823,046	1,213,216	2,212,706	1,987,122	1,769,021	28,826,535
Shpenzime jetese	1,575,580	281,892	281,892	328,671	328,671	409,860	409,860	409,860	409,860	409,860	348,870	282,048	439,996	448,552	470,184	6,835,656
Shpenzime per tatim mbi kalimin e te drejtes se pronesise se tokes are 890m2-2004			100,000													100,000
Shpenzim nga te ardhurat nga shitja e tokes 890m2 - 2004			4,900,000													4,900,000
Shpenzime riparim banese ne ***													500,000			500,000
Shpenzim per arsimim vajza											732,558	336,504	452,232	688,250	676,350	2,885,894
Shpenzime interesi kredia Intesa San Paolo 40,000\$			232,245	360,576	379,447	338,295	288,062	228,510	251,849	226,503	137,612	178,202	139,428	125,648	101,914	2,988,291
Shpenzime per nevoja familjare deklaruar ne pyetesor nga llog Banka Amerikane			506,960													506,960
Shpenzime kredie (disbursim, prim sigurimi,komisione)			160,282													160,282
Shpenzime interesi kredia UBA 50,000\$+shpenzime te tjera kredie	509,789	786,811														1,296,599
Shpenzime transporti Tirane - Vlore											108,000	108,000	108,000	108,000	108,000	540,000
Shpenzime mobilimi nga kredia Banka Amerikane 2004			2,983,200													2,983,200
Shpenzime udhetimi			78,579	93,802	139,518	510,240	918,941	773,639	195,722	12,447	496,006	308,462	573,050	616,672	412,574	5,129,652
Analiza dokumentuar	-11,839,673	-5,729,692	-939,979	-781,650	-1,572,619	-2,041,888	-1,287,710	2,772,134	-675,941	342,883	-2,672,967	-1,680,621	-917,011	-38,328,067	-697,384	
																Pamundesia financiare totale
																-69,165,202

Nga analiza financiare e këtyre viteve, rezultoi se subjekti i rivlerësimi nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për shtimin e likuiditetit dhe shpenzimet e kryera për jetesë dhe blerjet e pasurive ndër vite, në total në vlerën -69,165,202 lekë .

Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare.

Gjatë kësaj analize, Komisioni është bazuar në:

a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe të personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga bankat e nivelit të dytë: Credins Bank, Tirana Bank, Raiffeisen Bank, BKT, Intesa Sanpaolo Bank, Union Bank, ProCredit Bank, si dhe gjendjet *cash* të deklaruara nga subjekti.

b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:

i) Të ardhurat nga pagat e subjektit në: Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën 1996 – 1999, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për periudhën 2000 – 2001, Avokatin e Popullit për periudhën 2003 – 2011 dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë për periudhën 2012 – 2016.

ii) Të ardhurat nga pagat e bashkëshortes së subjektit në: gazetën “****” për periudhën 1998 – 2005, KLSH për periudhën 2014 – 2016, si dhe të ardhurat nga avokatia për periudhën 2008 – 2010. Të ardhurat e deklaruara nga subjekti, por të pakonfirmuara nga institucionet përkatëse, nuk janë përfshirë në analizën financiare.

Të ardhurat nga biznesi i avokatisë janë deklaruar në shumën totale prej 3,500,000 lekësh. Për sa i përket këtyre të ardhurave, për periudhën 2008 – 2010, në analizën financiare është zbatuar një marzh fitimi prej 80 % mbi xhiron maksimale të mundshme për secilin prej këtyre viteve. Komisioni merr parasysh faktin se ky biznes ka deklaruar xhiro 0 – 2.000.000 lekë për këtë periudhë dhe sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 17.7.2017, të Bashkisë Tiranë, janë shlyer të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore deri më 31.12.2012.

iii) Të ardhurat nga dëmshpërblimi i përfituar nga z. Skënder Haluci, si ish i përndjekur politik në vitin 2009, si dhe vitet 2013 – 2016.

iv) Të ardhurat nga shitja e tokës arë me sip. 890 m² nga znj. A.S., në vitin 2004.

v) Të ardhurat nga shitja e dyqanit në Rr. “****” nga z. Skënder Haluci në vitin 2003.

vi) Të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Benz” nga z. Skënder Haluci në vitin 2016.

c. Shpenzimet, ku përfshihen:

i) Shpenzimet e jetesës bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së familjes (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT).

ii) Shpenzime udhëtimi për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi *TIMS*. Për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit janë marrë si bazë shpenzimet mesatare të udhëtimeve sipas linjave ajrore, duke filluar nga 180 euro për udhëtim deri në 300 euro për udhëtim për linjat më të gjata.

Në rastet kur ka informacion për destinacionet e largëta, shpenzimet e udhëtimit janë llogaritur, duke parë në internet çmimet mesatare të destinacionit përkatës. Ndërsa për shpenzimet e qëndrimit janë llogaritur 50 euro/ditë shpenzim qëndrimi dhe ushqimi. Në rastet kur qëndrimi është deklaruar dhe vërtetuar me dokumentacion shkresor, të familjarët e subjektit/bashkëshortes, kemi llogaritur shpenzimin e udhëtimit, si më lart, si dhe kosto qëndrimi 20 euro/ditë). Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti/bashkëshortja kanë deklaruar e dokumentuar udhëtime për qëllime pune.

iii) Shpenzime riparim për banesën në Sauk deklaruar nga subjekti, arsimim fëmijësh të deklaruara nga subjekti në pyetësorët e dërguar nga Komisioni.

iv) Shpenzime transporti për vitet e punës në Vlorë.

v) Shpenzime tatimi për kalimine të drejtës së pronësisë për shitjen e tokës arë me sip. 890 m² në vitin 2004

vi) Shpenzime interesash dhe shpenzime të tjera të lidhura me kreditë në “UBA” dhe “Intesa Sanpaolo Bank”.

vii) Shpenzime nga të ardhurat nga shitja e tokës arë me sip. 890 m² në vitin 2004. Të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj toke në janar të vitit 2004 janë përfshirë edhe si shpenzim, pasi subjekti në deklaratën periodike për këtë vit, nuk deklaroi kursime *cash*.

ç. Në vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e shitblerjeve të këtyre pasurive.

Trupi gjykues, në përfundim të hetimit të kryer, në zbatim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar në njërin prej kriterëve të vlerësimit, atë të pasurisë, në vlerësimin tërësor të çështjes mbështetur në provat e administruara nga Komisioni, në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit, z. Skënder Haluci:

- ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën 1997 – 2016;
- ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për të ardhurat;
- ka bërë deklaram të pasaktë dhe të rremë lidhur me pasuritë e krijuara dhe burimin e ligjshëm;
- ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016;
- nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive, të tij dhe personave të lidhur në kuptim të nenin D, të Aneksit të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të gurmës “c”, të pikës 1, të nenit 58, dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Skënder Haluci, me funksion gjyqtar/kryetar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
2. Ky vendim, i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti irivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 5.3.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi Komici
Kryesues

Roland Ilia
Relator

Valbona Sanxhaktari
Anëtar

Gledis Hajdini
Sekretare gjyqësore